

INSTITUTI KOMBËTAR I
SHËNDETËSISË PUBLIKE
TË KOSOVËS



NATIONAL INSTITUTE
OF PUBLIC HEALTH OF
KOSOVA



Cilësia e
Ujit
të Pijshëm
në Kosovë
2016

RAPORT VJETOR
PËR CILËSINË E UJIT TË PIJSHËM NË KOSOVË 2016

I hartuar nga Qendra e Ujit e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike
me mbështetjen e Këshillit Ndërmintor për Ujëra

Prishtinë
qershor, 2017

Parathënie



Vitet e fundit ka pasur një angazhim të shtuar të IKSHPK-së mbështetur edhe nga Qeveria e Kosovës dhe donatorët për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm në frymën e mandatit që ka në pajtim me kuadrin e zbatueshëm ligjor. Si rezultat i këtij angazhimi, konsolidimi institucional i Qendrës së Ujit ka shënuar një progres substancial qoftë në planin e rritjes së kuadrit profesional gjithashtu edhe në atë të sigurimit të mjeteve të

nevojshme të punës (automjetet për nevojat qendrave rajonale, platforma softuerike për përpunimin e të dhënave të monitorimit etj.) si dhe kompletimit të parametrave të cilësisë që monitorohen. Këto zhvillime si dhe të tjerat që janë në progres përmes grupit koordinues ndërinstytucional të themeluar nga Këshilli Ndërmintrosor për Ujëra kanë për synim garantimin e sigurisë së cilësisë së ujit të pijshëm që konsumojnë qytetarët e Kosovës në pajtim me standardet e cilësisë të përcaktuara me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë. Ky legjislacion është plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Europian – Direktivën për Ujë të Pijshëm (Nr. 1983/98/EC).

Duke qenë ky raporti i dytë vjetor që e publikon IKSHPK, kam kënaqësinë të konstatoj se, krahasuar me vitin paraprak, rezultatet e monitorimit në vitin 2016 tregojnë një përmirësim të konsiderueshëm të cilësisë së ujit të furnizuar nga 7 Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit. Kështu, nga **50,289** teste të kryera gjatë vitit 2016, përputhshmëria me standardet e cilësisë mikrobiologjike është në shkallën **99.2%** (sipas Komisionit Europian, shkalla prej 99% e përputhshmërisë konsiderohet si përputhshmëri e plotë), ndërkaq përputhshmëria me standardet kimike në shkallën **98.0%**. Kjo rezulton me një shkallë të përgjithshme të përputhshmërisë prej **98.3%**.

Sfida më e madhe sa i përket sigurimit të cilësisë së ujit të pijshëm është mbajtja e trendit pozitiv të rezultateve të monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm edhe pas integrit të sistemeve komunale dhe atyre rurale të ujësjellësit brenda Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU). Integrimi i këtyre sistemeve brenda autoritetit menaxhues të Kompanive Rajonale të Ujësjellësit, është planifikuar të kryhet gjatë vitit 2017 dhe konsiderohet të jetë rruga e duhur për kontrollimin dhe sigurimin e cilësisë së ujit të këtyre sistemeve, duke pasur parasysh faktin se KRU-të posedojnë kapacitetet e nevojshme për të siguruar një gjë të tillë. Rrjedhimisht, siguri i cilësisë së ujit në këto sisteme të vogla, në pajtim me standardet e përcaktuara, do të kërkojë një angazhim shtesë të KRU-ve por edhe të IKSHPK.

Sfidë tjetër për IKSHPK është zbatimi i rregulloreve të nxjerra në pajtim me Udhëzimin Administrativ 16/2012 (gjegjësisht me Direktiva Evropiane për Ujin e Pijshëm), analizimi i parameterave të cilat aktualisht nuk monitorohen (para së gjithash pasticidet dhe benzeni). Adresimi me sukses i këtyre sfidave kërkon ngritjen e kapaciteve përmes kompletimit të stafit profesional dhe aftësimin të vazhdueshëm të tij.

Prej miratimit të UA 16/2012 ka pasur disa zhvillime në legjislacionin e BE-së (si amendamenti i Direktivës së Ujit të Pijshëm, miratimi i direktivës 2013/51/Euratom për monitorimin e cilësisë së ujit për parametrat radioaktiv) transpozimi i të cilave imponon rishikimin e këtij UA, për më tepër, kur të kihet parasysh se gjatë kësaj periudhe, IKSHPK ka identifikuar disa çështje të cilat kanë nevojë të rishikohen në UA 16/2012.

IKSHPK është i përkushtuar që të vazhdojë me punën e pakursyer për zbatimin e misionit dhe përgjegjësi që ka dhe unë shpresoj që për do të vazhdojmë ta kemi përkrahjen e donatorëve dhe të Qeverisë në sigurimin e ujit cilësor për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Profesor Naser Ramadani

Drejtor i IKSHPK-së

Përmbajtja

Përmbledhje	8
1 Hyrje.....	12
1.1 QËLLIMI I KËTIJ RAPORTI.....	12
1.2 KUADRI LIGJOR PËR CILËSINË E UJIT.....	12
1.3 KUADRI INSTITUCIONAL PËR CILËSINË E UJIT TË PIJSHËM.....	13
1.3.1 MINISTERIA E SHËNDETËSISË (MSH)	13
1.3.2 <i>Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike në Kosovë (IKSHPK)</i>	13
1.3.3 <i>Furnizuesit e Ujit–Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU)</i>	15
1.3.4 <i>Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU)</i>	15
1.3.5 <i>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)</i>	16
2 Monitorimi.....	17
2.1 MONITORIMI I JASHTËM NGA QENDRA E UJIT/IKSHPK.....	17
2.2 MONITORIMI I BRENDSHËM NGA KRU-TË	17
2.3 PARAMETRAT E TESTUAR NË VITIN 2016.....	18
2.3.1 <i>Parametrat të cilët nuk janë testuar</i>	18
2.3.3 <i>Parametrat radioaktiv</i>	20
2.4 VEPRIMET E IKSHPK NË RAST TË MOSPËRPUTHJES SË CILËSISË UJIT ME VLERAT PARAMETRIKE.....	20
3 Cilësia e Ujit në Zonat e Shërbimit të KRU-ve.....	21
3.1 KOMPANITË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT (KRU).....	21
3.2 CILËSIA E PËRGJITHSHME E UJIT TË PIJSHËM.....	22
3.3 CILËSIA E MIKROBIOLOGJIKE.....	23
3.4 CILËSIA E KIMIKE.....	23
4 Cilësia e ujit në Zonat e Furnizimit të KRU-ve.....	25
4.1 CILËSIA E UJIT NË ZFU-TË E KRU PRISHTINA	26
4.2 CILËSIA E UJIT NË ZFU-TË E KRU HIDROREGJIONI JUGOR.....	28
4.3 CILËSIA E UJIT NË ZFU-TË E KRU HIDRODRINI	30
4.4 CILËSIA E UJIT NË ZFU-TË E KRU RADONIQI.....	32
4.5 CILËSIA E UJIT NË ZFU-TË E KRU HIDROMORAVA	34
4.6 CILËSIA E UJIT NË ZFU-TË E KRU MITROVICA	36
4.7 CILËSIA E UJIT NË ZFU-TË E KRU BIFURKACIONI.....	38
4.8 PËRMBLEDHJE E CILËSISË SË UJIT NË ZONAT E FURNIZIMIT TË UJIT.....	41
5 Konkluzione: Sfidat e ardhshme.....	42
SHTOJCA 1: FJALORI I TERMAVE.....	45
SHTOJCA 2: ZONAT E SHËRBIMIT TË KRU-VE.....	50
SHTOJCA 3: PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE VJETORE PËR CILËSINË E UJIT PËR SECILËN KRU	57
SHTOJCA 4: PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TE AGREGUAR PËR ZFU	64

Lista e Tabelave

Tabela 1: Cilësia e ujit të pijshëm sipas parametrave bazik në zonat e furnizimit për vitin 2016	9
Tabela 2: Krahasimi i rezultateve të përputhshmërisë 2015-2016	10
Tabela 3: Të dhëna të përgjithshme për sistemet e ujësjellësit që menaxhohen nga KRU	21
Tabela 4: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU PRISHTINA	27
Tabela 5: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU HIDROREGJIONI JUGOR	29
Tabela 6: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini	31
Tabela 7: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU Radoniqi	33
Tabela 8: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU Hidromorava	35
Tabela 9: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU MITROVICA	37
Tabela 10: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU Bifurkacioni	39
Tabela 11: Përmbledhje e cilësisë së ujit në ZFU 2015-2016	41

Lista e Figurave

Figura 1: Shkalla e e përputhshmërisë me vlerat parametrike sipas KRU-ve dhe mesatarja në nivel të Kosovës.	8
Figura 2: Krahasimi i përputhshmërisë së përgjithshme sipas KRU-ve 2015-2016	22
Figura 3: Krahasimi i shkallës së përputhshmërisë mikrobiologjike 2015-2016	23
Figura 4: Krahasimi i shkallës së përputhshmërisë të parametrave kimik 2015-2016	24
Figura 5: Harta e zonave të furnizimit me ujë të KRU PRISHTINA	26
Figura 6: Harta e zonave të furnizimit me ujë të KRU HIDROREGJIONI JUGOR	28
Figura 7: Harta e zonave të furnizimit me ujë të KRU HIDRODRINI	30
Figura 8: Harta e zonave të furnizimit me ujë të KRU RADONIQI	32
Figura 9: Harta me zonat e furnizimit me ujë të KRU HIDROMORAVA	34
Figura 10: Harta me zonat e furnizimit me ujë të KRU MITROVICA	36
Figura 11: Harta me zonat e furnizimit me ujë të KRU BIFURKACIONI	38

Shkurtesat

AMRrSB	Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
DWD	Direktiva e Ujit të Pijshëm Nr. 98/83/EC (,Drinking Water Directive')
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovës
IT	Teknologjia Informative
KE	Komisioni Evropian
KNMU	Këshilli Ndërmëtor për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
PMUKR	Programi për Mbështetjen e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve Rurale
QK	Qeveria e Kosovës
QRSHP	Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike
SCO	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim
SHUKOS	Shoqata e Kompanive të Ujit në Kosovë
THM	Trihalometanet
UA	Udhëzimi Administrativ i Nr. 16/2012
ZFU	Zona e furnizimit me ujë

Përmbledhje

Ky raport jep një pasqyrë të përmbledhur të cilësisë së ujit të pijshëm të furnizuar përmes sistemeve publike të furnizimit me ujë. Popullsia e furnizuar përmes këtyre sistemeve është 1,533,000 banorë¹. Vlerësimi i cilësisë së ujit të pijshëm në raport është bërë bazuar në vlerat parametrike të cilësisë të përcaktuara me UA Nr. 16/2012 për secilën prej shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU) dhe për sektorin në përgjithësi.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të kryer nga Qendra e Ujit e Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK) konform përgjegjësiqe që ka kjo Qendër për monitorim të jashtëm sipas UA Nr. 16/2012, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve në **44 zona te furnizimit** (ZFU) të shtrira në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, është **99.2%** në përputhshmëri me vlerat parametrike mikrobiologjike, ndërkaj 98.0% në përputhshmëri me vlerat parametrike kimike, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej **98.3%**. Kjo shkallë e përputhshmërisë është rezultat i **50,289 testeve** të kryera gjatë vitit 2016 nga gjashtë laboratorët rajonalë të Qendrave Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRSHP) dhe Qendra e Laboratorëve Testues në IKSHPK.

Rezultatet krahasuese për shtatë KRU-të janë paraqitur në grafikun më poshtë në Fig. 1.




Figura 1: Shkalla e e përputhshmërisë me vlerat parametrike sipas KRU-ve dhe mesatarja në nivel të Kosovës.

¹ Bazuar në të dhënat e Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit për vitin 2016.

Siç mund të shihet nga grafiku i mësipërm, përputhshmëria më e lartë sa i përket vlerave të *parametrave mikrobiologjikë* ka qenë në KRU Radoniqi 100% dhe KRU Prishtina 99.9%, ndërsa përputhshmëria më e ulët në KRU Hidromorava 98% dhe KRU Hidroregjioni Jugor 98.3%.

Në anën tjetër, përputhshmëria më e lartë sa i përket *parametrave kimik* ka qenë në KRU Radoniqi me 100% përputhshmeri dhe KRU Mitrovica me 99.9%, ndërsa KRU Hidrodri me 97.0% dhe KRU Prishtina me 96.6% rezultojnë me përputhshmërinë më të ulët.

Një pasqyrë e përmblodhur e rezultateve të monitorimit sipas zonave të furnizimit është dhënë në tabelën vijuese.

Tabela 1: Cilësia e ujit të pijshëm sipas parametrave bazik ne zonat e furnizimit per vitin 2016

Parametrat	Numri i testeve të kryera	Përputhshmëria me vlerat parametrike	Tejkalimi i vlerave parametrike	
		%	Nr.	Nr. i ZFU-ve
Koliformet totale	5,525	98.9	61	21
E coli	5,525	99.6	24	9
Klori rezidual	5,485	89.6	569	25
Turbullira	5,518	99.1	50	11
Era	2,026	100	0	0.0
Shija	2,026	100	0	0.0
pH	2,027	100	0	0.0
Nitratet	1,740	99.9	2	1
Nitritet	1,779	100	0	0.0
Hekuri	1,855	99.9	2	1
Mangan	1,726	99.9	2	1
Alumini	1,025	99.7	3	2
Parametrat tjerë	14,032	99.7	37	15
Totali:	50,289	98.5	750	35

Krahasuar me vitin 2015, cilësia e ujit të pijshëm në vitin 2016 ka shënuar një përmirësim të theksuar. Kjo para së gjithash, e që është esencialisht e rëndësishme, vlen për cilësinë mikrobiologjike me përmirësim prej rreth 3% – nga 96.3 % në 99.2%. Në përgjithësi, shkalla e përputhshmërisë sa i përket parametrave mikrobiologjikë dhe atyre kimik është përmirësuar nga 97.6% në 98.3% (shih tabelën 2 më poshtë).

Tabela 2: Krahasimi i rezultateve të përputhshmërisë 2015-2016

Parametri	Përputhshmëria në 2015: 35 ZFU			Përputhshmëria në 2016: 44 ZFU		
	Nr. i testeve	%	ZFU me tejkalim	Nr. i testeve	%	ZFU me tejkalim
Koliformet totale	5,003	95.4	19	5,525	98.9	21
E coli	4,991	97.2	16	5,525	99.6	9
Klori rezidual	4,904	89	24	5,485	89.6	25
Turbullira	4,799	99.2	8	5,518	99.1	11
Era	1,760	100	0	2,026	100.0	0
Shija	1,760	100	0	2,026	100.0	0
pH	1,760	100	0	2,027	100.0	0
Nitratet	1,258	99.8	3	1,740	99.9	1
Nitritet	1,563	100.0	0	1,779	100.0	0
Hekuri	1,569	99.9	1	1,855	99.9	1
Mangan	1,306	99.0	10	1,726	99.9	1
Alumini	I përfshirë në "parametra të tjerë "me poshtë			1,025	99.7	2
Parametrat tjerë	12,692	99.3	19	14,023	99.7	15
Totali:	43,365	97.6		50,289	98.5	

Siç shihet nga tabela e mësipërme, rezultatet e monitorimit tregojnë se shkalla më e ulët sa i takon përputhshmërisë me vlerat parametrike ka të bëjë me klorin rezidual (89.6%) e që ka ndikuar në shkallën e përputhshmërisë me parametrat kimikë. Kjo indikon një problem operativ të cilin KRU-të duhet ta adresojnë në formën e duhur me klorinim të rregulltë dhe adekuat të ujit të cilin e furnizojnë. Parametrat tjerë kanë qenë përgjithësisht në nivel të kënaqshëm - mbi 99%², përpos koliformeve totale që është afër 99%.

Me qëllim të krijimit të një sistemi më efikas të monitorimit dhe të menaxhimit të cilësisë së ujit për pije në pajtim me standardet e zbatueshme, në periudhën e ardhshme fokusi i angazhimeve të Qendrës së Ujit të IKSHPK në bashkëpunim me institucionet relevante do të përqendrohet në adresimin e sfidave si vijon:

- Konsolidimi i mëtutjeshëm institucional i Qendrës së Ujit me personelin e nevojshëm në pajtim me strukturën e paraparë organizative.

² Niveli i përputhshmërisë prej 99% e më shumë, nga Komisioni Europian konsiderohet si 'përputhshmeri e plotë'.

-
- Krijimi i kapaciteteve për monitorimin e atyre parametrave të paraparë me UA 16/2012 të cilët aktualisht nuk monitorohen nga IKSHPK si pesticidet, benzeni etj.
 - Ngritja e kapaciteteve të KRU-ve për monitorimin e cilësisë së ujit që e furnizojnë: akreditimi i laboratorëve, krijimi i databazës për përpunimin e rezultateve të monitorimit të mbrendeshem, dhe kompletimi me personel i departamebteve të cilësisë së ujit.
 - Zbatimi efektiv nga institucionet përgjegjëse (IKSHPK, KRU-të, komunat, ARRU) i procedurave për menaxhimin e rasteve të mospërputhjes me vlerat parametrike të cilësisë së ujit të pijshëm.
 - Zgjidhja e qëndrueshme afatgjate e monitorimit të parametrave radioaktiv të cilësisë së ujit të pijshëm.

1 Hyrje

1.1 Qëllimi i këtij raporti

Në pajtim me mandatin ligjor që ka për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm, IKSHPK ka përgatitur këtë raport i cili jep një pasqyrë të përmbledhur të cilësisë së ujit të pijshëm të furnizuar përmes sistemeve publike të furnizimit me ujë. Vlerësimi i cilësisë së ujit të pijshëm në raport është bërë bazuar në vlerat parametrike të cilësisë të përcaktuara me UA Nr. 16/2012 për secilën prej shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU) dhe për sektorin në përgjithësi.

Raporti konsiderohet të jetë me interes për informimin e KRU-ve, palëve të interesit si dhe opinionit publik për cilësinë e ujit i cili furnizohet përmes sistemeve publike të furnizimit me ujë në Kosovë.

1.2 Kuadri ligjor për cilësinë e ujit

1.2.1 Ligji për Shëndetësinë Publike (Nr. 2/L-78)

Me Ligjin për Shëndetësinë Publike është përcaktuar që IKSHPK organizon, zhvillon, mbikëqyrë dhe zbaton politikat e shëndetësisë publike në Kosovë. Sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm, me këtë ligj (neni 4) është përcaktuar që IKSHPK kryen *analizimin dhe vlerësimin e kualitetit të ujit për pije*, ndërkaq me nenin 7 të këtij ligji theksohet se IKSHPK kryen *mbikëqyrjen dhe kontrollin e ujit të pijshëm*.

1.2.2 UA Nr. 16/2012 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor

Me UA Nr. 16/2012 është kompletuar kuadri ligjor për cilësinë e ujit të pijshëm në Kosovë dhe njëkohësisht është transpozuar në legjislacionin Kosovar Direktiva e Ujit të Pijshëm (DWD) Nr. 98/83/EC.

Ky UA është i zbatueshëm për *'ujin e destinuar për konsum nga njeriu'* që përfshin:

- Ujin e trajtuar që përdoret për pije, gatim, përgatitje të ushqimit, dhe për qëllime tjera në amvisëri nga rrjeti shpërndarës i ujësjellësit, i ambalazhuar në shishe, apo në cisterna; dhe
- Ujërat që përdoren në ndërmarrjet për prodhimin dhe përpunimin e ushqimit – përpos nëse cilësia e ujit nuk mund ta afektojë shëndetshmërinë e produktit final ushqimor.

Ky UA nuk zbatohet për ujërat termal si dhe për sistemet që furnizojnë mesatarisht më pak se 10m³ në ditë ose që shërbejnë më pak se 50 persona (përpos nëse uji është pjesë e veprimtarisë komerciale ose publike).

Për të verifikuar që uji për nevojat e konsumit nga njeriu i përmbushë kërkesat e cilësisë dhe vlerat parametrike të përcaktuara me këtë UA, me UA Nr. 16/2012 është përcaktuar obligimi që të kryhet monitorimi i rregulltë *i brendshëm* (përgjegjësi e furnizuesve të ujit – KRU-ve) dhe *i jashtëm* (përgjegjësi e IKSHPK-Qendra e Ujit) i cilësisë së ujit në *pikën e përputhshmërisë* që është pika e furnizimit dhe në rubinetë që përdoren për konsum nga njeriu.

Me këtë UA janë adresuar edhe (i) veprimet korigjuese dhe kufizimet në rastet kur uji nuk i përmbush standardet e përcaktuara, (ii) problematika e sigurimit të trajtimit, pajisjeve dhe materialeve të duhura që nuk e cenojnë cilësinë e ujit, (iii) çështja e njoftimit dhe udhëzimit të konsumatorëve kur uji nuk i përmbushë vlerat parametrike, si dhe (iv) aspektet e raportimit të KRU-ve tek IKSHPK-Qendra e Ujit, dhe të IKSHPK-së tek Qeveria dhe Komisioni Europian, etj.

1.3 Kuadri institucional për cilësinë e ujit të pijshëm

1.3.1 Ministria e Shëndetësisë (MSH)

Përgjegjësitë e MSH në zbatimin e UA 16/2012 kryesisht realizohen përmes IKSHPK. Megjithatë, MSH i ka disa përgjegjësi të veçanta si:

- Të përcaktojë sanksionet për mosrespektim të dispozitave të UA nr. 16/2012, në dakordim me IKSHPK;
- Të nxjerrë vendim për kushtet teknike për materialet dhe substancat që përdoren për përmirësimin e cilësisë së ujit apo për shpërndarjen e ujit të destinuar për konsum njerëzor;
- Të nxjerrë vendimet për nivelin e derogimit për vlerat parametrike.

1.3.2 Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike në Kosovë (IKSHPK)

Zbatimin e funksioneve të përcaktuara me nenin 4 dhe nenin 7 të Ligjit për Shëndetësinë Publike, për mbikëqyrjen dhe kontrollin të ujit të pijshëm, IKSHPK e kryen përmes Qendrës së Ujit sipas dispozitave të UA nr. 16/2012.

IKSHPK, respektivisht Qendra e Ujit e IKSHPK-së, si autoritet përgjegjës për analizimin dhe vlerësimin e kualitetit të ujit për pije, ka rol kryesor në zbatimin e UA Nr. 16/2012. Kjo sepse, me këtë Udhezim Administrativ IKSHPK është përcaktuar si institucion i cili ka për detyrë që t'i ndërmerr të gjitha masat për të siguruar që uji i cili përdoret për konsum nga njeriu të jetë i shëndetshëm dhe i pastër dhe që i përmbush kërkesat nga UA".

Përgjegjësitë e veçanta të IKSHPK përfshijnë:

-
- Të kërkojë nga furnizuesi i ujit (KRU) që të ndërmerr masat e nevojshme për të ulur apo eliminuar rrezikun e mospërputhjes me vlerat parametrike;
 - Të kryejë monitorimin e jashtëm të cilësisë së ujit të pijes;
 - Të vlerësojë përshtatshmërinë e ujit për konsum njerëzor;
 - Të hartojë programin e monitorimit që duhet të përfshijë inspektimin e sistemeve të ujit, përcaktimin e pikave të marrjes së mostrave dhe shpeshhtësinë;
 - Të sigurojë monitorim shtesë sipas rastit për substancat apo mikroorganizmat për të cilat nuk është përcaktuar ndonjë vlerë parametrike nëse ka arsye për të dyshuar se ato mund të jenë të rrezikshme për njeriun;
 - Të përcaktojë vlerat për parametrat shtesë që nuk janë përfshirë në UA n. 16/2012 kur është e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut;
 - Të ofrojë metodat referente të analizave që duhet të përdoren për parametrat e caktuar, në dakordim me MMPH;
 - Të njoftojë autoritetet komunale, ARRU dhe KRU në rast të mospërmbushjes së vlerave parametrike të ujit dhe tu rekomandojë autoriteteve përgjegjëse veprimet e duhura korrigjuese përfshirë edhe kufizimet e mundshme të përdorimit të ujit;
 - Të informojë dhe këshillojë konsumatorët në rast të mospërmbushjes së vlerave parametrike të ujit të pijes;
 - Të hartojë standardet dhe rregulloret teknike të përcaktuara me UA nr 16/2012 (trajtimin dhe dezinfektimin e ujit të pijshëm, mostrimin dhe kushtet e laboratorëve, menaxhimin e rreziqeve të rastet e mospërputhjes, etj);
 - Të marrë vendime pas mospërputhjes me vlerat parametrike;
 - Të kryejë menaxhimin e informatave dhe të raportojë pas konsultimit me ARRU dhe në dakordim me MMPH;
 - Të ofrojë lirime të përkohshme për përmbushjen e vlerave parametrike të parapara me UA nr. 16/2012;
 - Të hartojë dhe miratojë planet e veprimit për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm në dakordim me MMPH;
 - Të informojë popullatën për derogimin;

- Të publikojë raportin vjetor rreth cilësisë së ujit; përfshinë të gjitha sistemet individuale me mbi 1000 m³/ditë (apo mbi 5000 banorë).
- Të publikojë raportin 3-vjeçar (brenda 1 viti prej fundit te periudhës së raportimit) rreth cilësisë së ujit; përfshinë të gjitha sistemet individuale me mbi 1000 m³/ditë (mbi 5000 banorë).

1.3.3 Furnizuesit e Ujit–Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU)

KRU-të si furnizues të ujit të pijshëm (ujit për konsum njerëzor) kanë përgjegjësi që të sigurojnë që cilësia e ujit të cilin e furnizojnë të jetë në përputhje me parametrat e përcaktuara në UA.

Përgjegjësitë specifike të KRU-ve që dalin nga UA 16/2012 përfshijnë si vijon:

- Të kryejnë monitorimin e brendshëm të cilësisë së ujit – në pikat e marrjes së ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor, në fabrikat e trajtimit, rezervuarët dhe sistemin shpërndarës. Për monitorim të brendshëm KRU-të mund të përdorin laboratorë të brendshëm apo të nënkontraktuar;
- Të informojnë në baza vjetore tek IKSHPK për të gjitha rastet e mospërputhjes të identifikuar gjatë vitit paraprak;
- Të aranzhojnë pikat e mostrimit dhe shpeshtësinë e inspektimeve – në bashkëpunim me IKSHPK;
- Të kompletojnë laboratorin në të cilin analizohen mostrat i cili duhet të ketë një sistem te kontrollit të cilësisë analitike që i nënshtrohet verifikimit nga një organ jashtëm i kontrollit të laboratorit dhe që është miratuar nga autoritetet e shëndetësor;
- T'i ruajnë rezultatet e monitorimit për një periudhë, së paku 5 vjeçare;
- Të kryejnë hetime të menjëhershme në bazë të udhëzimeve të IKSHPK për identifikimin e shkakut të mospërputhjes dhe për të rikthyer cilësinë e ujit sa më shpejtë që është e mundur;
- Të informojnë dhe këshillojnë konsumatorët për veprim në rast të mospërputhjes së vlerave parametrike të ujit të pijshëm;
- Të informojnë popullatën për derogimin.

1.3.4 Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU)

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) si rregullator i pavarur ekonomik për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë, ka përgjegjësi që të sigurojë ofrimin e

shërbimeve cilësore, efiçente, dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për të gjithë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

Në kontekstin e cilësisë së ujit të pijshëm, legjislacioni i ARRU është kompatibil me UA Nr. 16/2012, që d.m.th. kërkohet që cilësia e ujit të cilën e furnizojnë KRU-të jetë në pajtim me standardet e kërkuara dhe gjithashtu kërkohet që në rast të mospërbushjes së standardeve, KRU-të duhet të informojnë IKSHPK dhe ARRU dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme korrigjuese në pajtim me udhëzimet e IKSHPK duke përfshirë edhe informimin e konsumatorëve.

Duke qenë autoritet që licencon KRU-të, ARRU duhet të sigurohet që cilësia e ujit të furnizuar të jetë në pajtim me standardet.

ARRU dhe IKSHPK kanë bashkëpunim të ngushtë sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm që furnizohet nga KRU-të, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar në mes të këtyre dy institucioneve në vitin 2007. Një segment i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi i rregullt i të dhënave për cilësinë e ujit të pijshëm.

1.3.5 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) duke qenë autoritet përgjegjës për menaxhimin e resurseve ujore, në kontekstin e cilësisë së ujit ka përgjegjësi që t'i mbikëqyrë zonat mbrojtëse të burimeve të ujit që shfrytëzohen për pije dhe zbatimin e masave mbrojtëse në këto zona.

MMPH, përmes Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, ka përgjegjësi monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Këto rezultate të monitorimit i shfrytëzon IKSHPK për zbatimin e monitorimit të jashtëm të cilësisë së ujit të destinuar për konsum njerëzor.

Me UA nr. 16/2012 është përcaktuar që MMPH duhet të bashkëpunojë me IKSHPK në çështje të ndryshme përfshirë:

- Hartimin dhe nxjerrjen e rregulloreve teknike në lidhje me transportin e ujit të destinuar për konsum nga njeriu dhe për materialet dhe substancat në kontakt me ujin;
- Ofrimin e lirimeve të përkohshme për përmbushjen e vlerave parametrike ;
- Hartimin e kushteve lidhur me rastet e jashtëzakonshme që kërkojnë kërkesa të jashtëzakonshme;
- Hartimin e planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

2 Monitorimi

2.1 Monitorimi i jashtëm nga Qendra e Ujit/IKSHPK

Kërkesat për "monitorim" në nenin 7 të Direktivës përputhen në masë të madhe me kërkesat e përcaktuara në nenin 8 të UA 16/2012 për monitorim të jashtëm. Kërkesat e detajuara për monitorimin e jashtëm janë përkufizuar në nenin 8.1 të UA 16/2012 i cili thekson se monitorimi i jashtëm konsiston nga të gjitha masat e ndërmarra nga autoriteti shëndetësor (d.m.th., Qendra e Ujit e IKSHPK-së) për të verifikuar se uji që është në dispozicion të konsumatorëve i përmbush kërkesat e UA 16/2012, bazuar në programin e monitorimit të krijuar nga autoriteti shëndetësor i cili verifikon se uji në dispozicion të konsumatorëve i përmbush vlerat parametrike në Shtojcën 1 dhe që janë mostra që merren në pikën e furnizimit të specifikuar në nenin 5.1 (zakonisht në rubinet, ku uji furnizohet nga rrjeti i shpërndarjes).

Pra, si përmbledhje, sipas Direktivës dhe siç është transpozuar në UA 16/2012, monitorimi i jashtëm është:

- Përgjegjësi e autoritetit shëndetësor, i cili i përcakton (i) pikat e marrjes së mostrave, (ii) parametrat që analizohen dhe (iii) shpeshhtësinë minimale në pajtim me kërkesat e Shtojcën 2.
- I nevojshëm për të siguruar që uji në dispozicion të konsumatorëve i përmbush të gjitha vlerat parametrike të përcaktuara në Shtojcën 1.
- I bazuar në mostrat e marra në pikën e furnizimit të konsumatorit, që në rastin e rrjetit të shpërndarjes është zakonisht në rubinetin e konsumatorit.

Të dhënat mbi cilësinë e ujit të pijshëm mbi të cilat është përpiluar ky raport bazohen krejtësisht në monitorimin e jashtëm nga laboratorët rajonalë të IKSHPK-së dhe Qendra e Laboratorëve Testuese të IKSHPK-së në Prishtinë.

2.2 Monitorimi i brendshëm nga KRU-të

Monitorimi i brendshëm është përgjegjësi e „furnizuesve të ujit“ (KRU-ve) dhe rezultatet e monitorimit „të brendshëm“ janë kryesisht për përdorim operacional të vet KRU-ve – para së gjithash për të „verifikuar cilësinë e ujit për konsum nga njerëzit në tërë sistemin e furnizimit me ujë“. Megjithatë, nuk ka kërkesë të obligueshme në UA 16/2012 që KRU-të të ndajnë të dhënat e monitorimit të brendshëm me IKSHPK-në, përveç siç kërkohet në nenin 13 të UA 16/2012 lidhur me parametrat e indikatorëve.

Pra, si përmbledhje, sipas UA 16/2012, monitorimi i brendshëm:

- Bëhet nga furnizuesi i ujit (d.m.th., nga KRU).
- Qëllimi i theksuar i monitorimit të brendshëm nga furnizuesi i ujit (neni 7.1) është “për të verifikuar cilësinë e ujit për konsum njerëzor brenda tërë sistemit të ujit”.
- Pikat e mostrave dhe shpeshtësia e inspektimit nuk janë përkufizuar (për dallim nga kërkesat e monitorimit të jashtëm në pajtim me Shtojcën 2), dhe “mund” të rregullohen me autoritetin shëndetësor.
- Nuk ka kërkesë që mostrat të përmbushin vlerat parametrike në Shtojcën 2 (për dallim nga monitorimi i jashtëm ku kjo kërkohet shprehimisht në nenin 8.1).
- Pasi që monitorimi i brendshëm aplikohet për “tërë sistemin e ujit”, pikat e mostrave duhet po ashtu të mbulojnë tërë sistemin e ujit dhe ndryshe nga monitorimi i jashtëm, nuk janë specifikuar në pikën e furnizimit – zakonisht në rubinetin e konsumatorëve ku uji furnizohet nga rrjeti i shpërndarjes.
- Nuk ka obligim mandator për furnizuesin e ujit që, ose të pajtohet për pikat e mostrimit dhe shpeshtësinë e monitorimit të brendshëm me autoritetin shëndetësor, ose që të ndajë rezultatet e analizave me autoritetin shëndetësor.
- Furnizuesit të ujit i kërkohet të njoftojë autoritetin shëndetësor për rastet e mospërputhjeve të identifikuara gjatë vitit paraprak (duke nxjerr ato të identifikuara përmes monitorimit të brendshëm) por kjo aplikohet vetëm për parametrat e indikatorëve.
- Analiza e mostrave duhet të bëhet nga një laborator i akredituar me aprovimin e autoritetit shëndetësor.
- Nevoja e furnizuesi me ujë të prodhojë informacione analitike mbi cilësinë e ujit nga aktiviteti i monitorimit të brendshëm për qëllime operationale nuk përmendet askund në UA 16/2012.

2.3 Parametrat e testuar në vitin 2016

2.3.1 Parametrat të cilët nuk janë testuar

Prej 48 parametrave të përfshirë në Direktivën e Ujit të Pijshëm (DWD) dhe të transpozuar në UA 16/2012, në vitin 2016 nuk është bërë testimi rutinor nga laboratorët e IKSHPK-së për parametrat në vijim:

- Benzeni
- Benzo 3,4 pirini (a PAH)
- Bromati³
- 1,2 dykloretani
- Bori⁴
- Pesitacidet individuale⁵
- Pesticide totale
- Hidrokarburet poli-aromatike⁶ (PAH).
- Trikloreteni dhe tetrakloreteni⁷
- Vinil kloridi, epiklorhidrini dhe akrilamidini⁸
- Tritiumi dhe doza totale indikative⁹



2.3.2 Klori i rezidual

Niveli i klorit rezidual¹⁰ në ujën e pijshëm nuk është parametër i obligueshëm në DWD, por është përfshirë si parametër kombëtar në Kosovë në UA 16/2012. Përputhshmëria me vlerën parametrike të klorit rezidual është e ndërlidhur me përputhshmërinë me standardet mikrobiologjike.

³ Në përgjithësi monitorohet kur ozonimi përdoret si dezinfektues

⁴ Zakonisht rrjedh nga mbetjet në detergjentet e pranishme në derdhjet e ujërave të zeza të trajtuara. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin asnjë rrezik për shëndetin.

⁵ Me përkrahjen e qeverisë Franceze, gjatë vitit 2016 janë zhvilluar analiza të këtij parametri, dhe rezultatet e fituara nuk tregojnë tejklaime të vlerave parametrike.

⁶ Zakonisht lidhet me shtresën e katranit në gypat e hekurit të para viteve 1970ta dhe nuk konsiderohet relevante për Kosovën

⁷ Tretës të pranishme në përqendrime të vogla në ujërat nëntokësore nën zonat industriale. Ka pak mundësi që të jetë relevante për Kosovën.

⁸ Nuk është subjekt i analizës kimike dhe zakonisht kontrollohet sipas specifikimit të produktit

⁹ Përgjegjësia për monitorimin e substancave radioaktive i takon Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

¹⁰ Duhet theksuar se aty ku regjistrohet mospërputhshmëri për klorin rezidual kjo do të thotë se në mostrën e analizuar nuk është matur minimumi i përqendrimit të përcaktuar kombëtar prej 0.2 mg/l. Kjo nuk tregon domosdoshmëri se ka pasur përqendrim zero të mbetjes së klorit në mostrë.

2.3.3 Parametrat radioaktiv

Parametrat radioaktiv që sipas UA 16/2012, duhet të monitorohen (tritiumi dhe ID-doza indikative), aktualisht monitorohen nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB). Kjo Agjenci në bashkëpunim me laboratorin IRE ELIT-Begjikë, edhe në vitin 2016 (sikurse edhe në disa vite paraprake) kanë analizuar mostrat e ujit të pijshëm në nivel të vendit. Rezultatet tregojnë se në të gjitha mostrat e analizuarat të ujit tritiumi dhe ID janë *brenda vlerave të lejuara* parametrike sipas Direktivës Evropiane 2013/51/ Euroatom¹¹.

Për vitin 2017, është e nevojshme që *AKMRrSP të koordinohet me IKSHPK* për përzgjedhjen e pikave dhe frekuencën e mostrimit, në mënyrë që kjo të bëhet në pajtim të plotë me kërkesat e Direktivës 2013/51/Euratom.

2.4 Veprimet e IKSHPK në rast të mospërputhjes së cilësisë ujit me vlerat parametrike

Në rast se regjistrohet ndonjë mospërputhshmëri në analizën për parametrat mikrobiologjikë pas analizës së mostrave nga stafi i laboratorit të IKSHPK-së në zonën e furnizimit të KRU-së, duhet të ndërmerren veprime rikuperuese në pajtim me përgjegjësitë institucionale të përcaktuara me kuadrin ligjor. Veprimet specifike të cilat duhet të ndërmerren nga KRU-të dhe palët tjera relevante (IKSHPK, komunat) janë definuar me procedurat e hartuara së voni nga Grupi Koordinues i themeluar nga Këshilli Ndërmintor për Ujëra. Këto procedura duhet të miratohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe rrjedhimisht të zbatohen nga palët relevante, d.m.th. nga KRU-të, IKSHPK dhe komunat.



¹¹ Final Report: Bilateral Cooperation Program 2016, Kosovo-Belgium, AKMRrSB.

3 Cilësia e Ujit në Zonat e Shërbimit të KRU-ve

Në këtë pjesë të raportit është dhënë një përmbledhje e cilësisë së përgjithshme të ujit të pijshëm në Kosovë që u është ofruar konsumatorëve nga shtatë Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU-të) gjatë vitit 2016 si dhe krahasimi i këtyre rezultateve me ato të vitit 2015, bazuar në monitorimin e kryer nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së në pajtim me dispozitat e nenit 8 të UA nr. 16/2012.

Kjo përmbledhje përfshin informacionet statistikore për **zonat e shërbimit** të KRU-ve si dhe për nivelin e përputhshmërisë së përgjithshme me standardet e cilësisë dhe vlerat parametrike të ujit të pijshëm.

3.1 Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU)

Shërbimet e ujit, si shërbime të ujësjellësit dhe shërbime të kanalizimit të ujërave të zeza, janë në masë të madhe (por ende jo krejtësisht) nën përgjegjësinë e KRU-ve. KRU-të janë themeluar në periudhën 2002–2006, dhe të njëjtat janë pronë e shtetit, nën kontrollin e Qeverisë së Kosovës (përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik). Secila KRU është e regjistruar si ndërmarrje publike, dhe e licencuar për furnizim me ujë nga Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU). Një përmbledhje me të dhënat kryesore për KRU-të është dhënë në tabelën 3 më poshtë.

Tabela 3: Të dhëna të përgjithshme për sistemet e ujësjellësit që menaxhohen nga KRU¹²

Numri i Kompanive të Ujësjellësit	7
Numri i konsumatorëve	335,647
Numri i popullsisë së furnizuar (milion)	1.53
Sasia e ujit të furnizuar (milion m ³)	143.6
Gjatësia e rrjetit të ujësjellë (km)	4,620
Burimet sipërfaqësore të ujit	53%
Burimet nëntokësore të ujit	47%
Numri i zonave të furnizimit	44

¹² Të dhënat i referohen vitit 2016 dhe janë ofruar nga ARRU.

3.2 Cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm

Cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve nga shtatë KRU-të, dhe që monitorohet nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së në kuadër të përgjegjësive të saj për monitorim të jashtëm të përcaktuara në UA 16/2012, ka arritur një përputhshmëri me 99.2 % sa i takon standardeve *mikrobiologjike* të cilësisë së ujit, ndërkaq 98.0% sa i takon standardeve *kimike*, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej 98.3%. Kjo shkallë e përputhshmërisë është e bazuar në rezultatet e mbi 50,289 testeve të bëra nga gjashtë laboratorët rajonal të Qendrave Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRSHP) dhe nga laboratorit qendror i IKSHPK-së në Prishtinë gjatë 12 muajve të vitit 2016 në pajtim me programin e monitorimit të Qendrës së Ujit të IKSHPK.

Niveli i përputhshmërisë së përgjithshme në vitin 2016 është përmirësuar në krahasim me vitin 2015 (nga 97.6% në 98.3%).

Krahasimi i shkallës së përputhshmërisë sipas KRU-ve dhe në nivel të Kosovës është paraqitur në Figurën 2 më poshtë:




Figura 2: Krahasimi i përputhshmërisë së përgjithshme sipas KRU-ve 2015-2016

Siç mund të shihet, përmirësimi më i theksuar në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 është shënuar në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini (nga 90.7% në 97.4%), që edhe përkundër përmirësimit të madh, mbetet ende me shkallën më të ulët të përputhshmërisë së përgjithshme me 97.4%. Shkalla më e lartë e përputhshmërisë së përgjithshme është konstatuar në zonën e shërbimit të KRU Radoniqi, ku është konstatuar shkallë e plotë e përputhshmërisë prej 100%.

3.3 Cilësia e mikrobiologjike

Niveli i përputhshmërisë me standardet mikrobiologjike të cilësisë së ujit të pijshëm ka dalluar, nga KRU-Radoniqi që ka rezultuar me 100% përputhshmëri deri te KRU-Hidromorava që ka rezultuar me 88% përputhshmëri.

Në figurën 3 janë paraqitur në formë grafike shkalla e përputhshmërisë së cilësisë së ujit të pijshëm me standardet e përcaktuara për vitin 2016 dhe e krahasuar me shkallën e përputhshmërisë për vitin 2015.




Figura 3: Krahasimi i shkallës së përputhshmërisë mikrobiologjike 2015-2016

Siç shihet në grafikun më lartë, edhe sa i përket përputhshmërisë mikrobiologjike, KRU Hidrodrini ka shënuar një përmirësim shumë të theksuar. Krahasuar me vitin 2015 në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini, është shënuar një përmirësim prej 12% - nga 87.1% në 99.1%. Në përgjithësi, shkalla mesatare e përputhshmërisë mikrobiologjike në nivel të vendit prej 99.2% është një nivel shumë i lartë i përputhshmërisë (sipas Komisionit Europian ky nivel konsiderohet ,përputhshmëri e plotë') dhe indikon një cilësi shumë të mirë të përgjithshme të ujit i cili furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit.

3.4 Cilësia e kimike

Siç shihet në grafikun më poshtë (Figura 4), në vitin 2016 krahasuar me 2015 është shënuar përmirësim i cilësisë edhe sa i përket parametrevë kimik, edhe pse vetëm 0.5 % në nivel të Kosovës. Edhe këtu, përmirësimi më i theksuar është shënuar në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini.

Niveli i përputhshmërisë me standardet kimike të cilësisë së ujit ka variuar ndërmjet KRU Radoniqi me 100% përputhshmëri deri te KRU Prishtina me 96.6% (te kjo e fundit si rezultat i mospërputhjes me vlerave parametrike për klorin rezidual dhe atë në zonat e furnizimit PR04-Fushe Kosova me 92.33% dhe PR05-Obiliqi me 93.00%).




Figura 4: Krahasimi i shkallës së përputhshmërisë të parametrave kimik 2015-2016

Niveli mesatar në nivel të vendit prej 98% që, përkundër përmirësimit të arritur në krahasim me vitin 2015, mund të konsiderohet si jo i kënaqshëm, i atribuohet para së gjithash parametrit të klorit rezidual, parametër ky që nuk është i obligueshëm me Direktivën e BE-së dhe që mospërmbushja e tij në vlerën e përcaktuar parametrike prej minimum 0.2 mg/l nuk tregon domosdoshmërisht se ka pasur ndotje mikrobiologjike. Përkundër kësaj, KRU-të (Hidrodrini, Prishtina, Hidromorava) duhet të përmirësojnë aspektet operative të lidhura me klorimin e ujit në mënyrë që të përmirësojnë rezultatet e cilësisë kimike në pajtim me standardet e përcaktuara me UA 16/2012.

4 Cilësia e ujit në Zonat e Furnizimit të KRU-ve

Sipas UA nr. 16/2012 zonat e furnizimit me ujë (ZFU) janë "element" kryesor për menaxhimin dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e ujit të pijshëm. ZFU janë përkufizuar në UA 16/2012 si: *"Zona e furnizimit është zona e definuar gjeografike brenda së cilës uji që synohet të përdoret për konsum njerëzor vie prej një apo më shumë burimeve brenda të cilës kualiteti i ujit konsiderohet se është përafërsisht uniform"*.

Në total janë përcaktuar 44¹³ ZFU për zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve – secila prej KRU-ve ka një numër relativisht të vogël të ZFU-ve (maksimum 3 deri 10).

Në këtë kapitull janë paraqitur rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm të furnizuar gjatë vitit 2016 të përpunuara sipas ZFU të shtatë KRU-ve.

¹³ Numri i zonave të furnizimit në vitin 2016 është rritur në 44 prej 35, sa ishin në vitin 2015; të gjitha 9 zonat e reja janë zona të vogla të tipit dy (nën 1000 m³/ditë).

4.1 Cilësia e Ujit në ZFU-të e KRU Prishtina

Në zonën e shërbimit të KRU Prishtina janë identifikuar 9 zona të furnizimit me ujë, të cilat janë paraqitur në hartën në Figurën 5 më poshtë.




Figura 5: Harta e zonave të furnizimit me ujë të KRU PRISHTINA

Të dhënat kryesore të këtyre ZFU si dhe cilësia kimike dhe mikrobiologjike në këto zona, si shkallë e përputhshmërisë me vlerat parametrike të cilësisë të përcaktuara me UA nr. 16/2012, është paraqitur në tabelën 4 më poshtë. Të dhënat e detajuara për parametra individual për ZFU-të, ndërkaq, janë dhënë në Shtojcën 4 të këtij raporti.

Tabela 4: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU PRISHTINA

Nr	Zona e furnizimit	Lloji i burimit	Përshkrimi i zonës administrative	Konsumi ditor (m ³ /ditë)	Shkalla e përputhshmërisë (%)	
					mikrob.	kimike
1	PR 01	Sipërfaqësor (Liçeni i Batllavës)	Komuna e: Prishtinës (60%), Podujevës (80%) dhe Obiliqit (70%)	51,840	100.0	96.50
2	PR 02	Sipërfaqësor (Liçeni i Batllavës dhe Badovcit)	Komuna e Prishtinës (20%)	30,240	99.84	98.93
3	PR 03	Sipërfaqësor (Liçeni i Badovcit)	Komuna e Prishtinës (20%) dhe Graçanicës (100%)	14,688	100.0	97.17
4	PR 04	Nëntokësor (Puset e Kuzmin)	Komuna e Fushë Kosovës (100%)	9,072	99.48	92.33
5	PR 05	Nëntokësor (Puset e Hashanëve)	Komuna e Obiliqit (30%)	1,728	100.0	93.01
6	PR 06	Nëntokësor (Puset e Shtimjes)	Komuna e Shtimjes (100%)	2,670	98.96	98.72
7	PR 07	Nëntokësor (Puset e Lipjanit)	Komuna e Lipjanit (100%)	6,128	100.0	99.06
8	PR 08	Sipërfaqësor (Liçeni i Ujmanit)	Komuna e Drenasit (100%)	6,048	100.0	96.02
9	PR 09	Nëntokësor (Puset në Peran)	Komuna e Podujevës (20%)	1,728	100.0	94.90
Zona e Shërbimit				124,142	99.9	97.0

Nga tabela e mësipërme mund të shihet qartë se:

- (i) **cilësia mikrobiologjike e ujit në përgjithësi ka qenë në një nivel shumë të lartë**, me shkallën e përputhshmërisë pothuajse 100% (99.9%). Ky fakt është veçanërisht me rëndësi dhe pozitiv kur dihen efektet negative në shëndetin e popullatës nga ndotja mikrobiologjike. Vetëm në Shtimje shkalla e përputhshmërisë ka qenë pak nën 99%.
- (ii) Në anën tjetër, në aspektin e **përputhshmërisë kimike rezultatet kanë treguar një shkallë më të ulët të përputhshmërisë (97%)**, me rezultatet më të dobëta të shënuara në Fushë Kosovë (92.3%) dhe Obiliq (93%). Kjo shkallë e ulët e cilësisë kimike vjen si rezultat i mospërputhshmërisë në lidhje me, para së gjithash, *klorin rezidual* dhe *turbullirën*.

4.2 Cilësia e Ujit në ZFU-të e KRU Hidroregjioni Jugor

Në zonën e shërbimit të KRU Hidroregjioni Jugor janë përcaktuar 4 zona të furnizimit me ujë (shih hartën e dhënë në Figurën 6 mëposhtë).




Figura 6: Harta e zonave të furnizimit me ujë të KRU HIDROREGJIONI JUGOR

Të dhënat kryesore të këtyre ZFU-ve si dhe shkalla e përputhshmërisë mikrobiologjike dhe kimike të cilësisë së ujit të furnizuar me vlerat parametrike janë paraqitur në tabelën 5 më poshtë.

Tabela 5: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU HIDROREGJIONI JUGOR

Nr	Zona e Furnizimit	Lloji i burimit	Përshkrimi i zonës administrative	Konsumi ditor (m ³ /ditë)	Shkalla e përputhshmërisë (%)	
					mikrobiol.	kimike
1	HRJ 01	Nëntokësor (40 puse, burimi Nashec, Cvileni)	Qyteti dhe fshatrat e komunës së Prizrenit	38,000	99.08	99.86
2	HRJ 02	Sipërfaqësor (lumi Radesh)	Komuna e Dragashit	1,200	95.83	99.74
3	HRJ 03	Nëntokësor	Komuna e Malishevës	3,700	95.83	99.71
4	HRJ 04	Nëntokësor	Komuna e Suharekës	5,800	94.55	99.35
Zona e Shërbimit				48,700	98.3	99.8

Nga tabela e mëposhtme mund të konstatohet sa vijon:

- (i) cilësia mikrobiologjike e ujit me shkallë të përputhshmërisë prej 98.3% është nën nivelin mesatar të vendit;
- (ii) në kuptimin territorial, **përputhshmëria mikrobiologjike ishte në nivel të kënaqshëm në komunën e Prizrenit**, ndërkaq në të gjitha 3 komunat tjera në një nivel relativisht të ulët (rreth 95%), si pasojë e problemit të dezinfektimit joadekuat;
- (iii) **shkalla e përputhshmërisë për parametrat kimik në nivelin prej 99.8% indikon një cilësi të lartë të ujit të furnizuar**, e cila është pothuajse uniforme në të gjithë zonën e shërbimit.

4.3 Cilësia e Ujit në ZFU-të e KRU Hidrodrini

Në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini janë përcaktuar 5 ZFU të cilat janë paraqitur në formë grafike në hartën në Figurën 7 më poshtë.




Figura 7: Harta e zonave të furnizimit me ujë të KRU HIDRODRINI

Të dhënat kryesore të këtyre ZFU-ve si dhe shkalla e përputhshmërisë mikrobiologjike dhe kimike të cilësisë së ujit të furnizuar me vlerat parametrike janë paraqitur në tabelën 6 më poshtë.

Tabela 6: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini

Nr	Zona e Furnizimit	Lloji i burimit	Përshkrimi i zonës administrative	Konsumi ditor (m ³ /ditë)	Shkalla e përputhshmërisë (%)	
					mikrobiol.	kimike
1	HD 01	Nëntokësor (burimet Drini i Bardhë dhe Uji i Zi)	Komuna e Pejës	58,000	99.62	98.80
2	HD 02	Nëntokësor (burimi Istog)	Komuna e Istogut	11,000	99.65	95.72
3	HD 03	Nëntokësor	Komuna e Deçanit	3,500	97.45	89.90
4	HD 04	Nëntokësor	Komuna e Junikut	1,100	96.72	93.86
5	HD 05	Nëntokësor (burimi Jarina)	Komuna e e Klinës	1,900	98.41	93.94
Zona e Shërbimit				75,500	99.1	97

Nga rezultatet e paraqitura në tabelën e mësipërme mund të nxjerren konkluzionet vijuese:

- (i) Cilësia e ujit të furnizuar nga KRU Hidrodrini në aspektin mikrobiologjik është përgjithësisht në një nivel të kënaqshëm, me shkallë të përputhshmërisë prej 99.1% në nivel të zonës së shërbimit të Kompanisë;
- (ii) Sa i përket parametrave kimik ka pasur një shkallë të mospërputhshmërisë prej 3% e cila ka qenë më e theksuar në komunën e Deçanit (përputhshmëria prej 89.9%), po me shkallë të ulët të përputhshmërisë edhe në komunat tjera, përpos Pejës;
- (iii) KRU Hidrodrini duhet t'i shqyrtojë dhe adresojë në mënyrë adekuate faktorët që kanë impakt në cilësinë kimike të ujit, mbi të gjitha ta adresojë në mënyrë adekuate klorimin efektiv të ujit në të gjitha sistemet e ujësjellësit brenda zonës së vet të shërbimit.

4.4 Cilësia e Ujit në ZFU-të e KRU Radoniqi

Zona e shërbimit e KRU Radoniqi përfshin 4 ZFU të cilat janë paraqitur në hartën në Figurën 8 më poshtë.




Figura 8: Harta e zonave të furnizimit me ujë të KRU RADONIQI

Cilësia mikrobiologjike dhe kimike e ujit të furnizuar në katër ZFU-të e KRU Radoniqi janë paraqitur në tabelën 7 më poshtë.

Tabela 7: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU Radoniqi

Nr	Zona e Furnizimit	Lloji i burimit	Përshkrimi i zonës administrative	Konsumi ditor (m ³ /ditë)	Shkalla e përputhshmërisë (%)	
					mikrobiol.	kimike
1	RA 01	Sipërfaqësor (Liqeni i Radoniqit)	Komuna e Gjakovës	25,000	100	100
2	RA 02	Sipërfaqësor (Liqeni i Radoniqit)	Komuna e Rahovecit	5,500	100	100
3	RA 03	Sipërfaqësor (Liqeni i Radoniqit)	Fshaterat-Komuna e Prizrenit	4,500	100	100
4	RA 04	Nëntokësor (Burimi Demjan)	Damjan-Komuna e Gjakovës	1,450	100	100
5	RA 05	Nëntokësor (Burim natyror)	Drenoc-Komuna e Rahovecit	101	100	100
6	RA 06	Nëntokësor (Burim natyror)	Opterushë-Komuna Rahovecit	168	100	100
7	RA 08	Nëntokësor (Burim natyror)	Senoc-Komuna e Rahovecit	23	100	100
8	RA 010	Nëntokësor (Burim natyror)	Gërqinë-Komuna e Gjakovës	35	100	100
Zona e Shërbimit				37,107		

Është e qartë që cilësia e ujit e furnizuar nga KRU Radoniqi ka qenë plotësisht brenda vlerave parametrike dhe kjo është padyshim një dëshmi e një angazhimi menaxherial dhe operativ shembullor.

4.5 Cilësia e Ujit në ZFU-të e KRU Hidromorava

Zona e shërbimit e KRU Hidromorava janë përcaktuar 6 zona të furnizimit me ujë shtrirja dhe kufijtë e të cilave janë paraqitur në hartën në Figurën 9 më poshtë.




Figura 9: Harta me zonat e furnizimit me ujë të KRU HIDROMORAVA

Të dhënat kryesore të këtyre ZFU-ve si dhe shkalla e përputhshmërisë mikrobiologjike dhe kimike të cilësisë së ujit të furnizuar me vlerat parametrike janë paraqitur në tabelën 8 më poshtë.

Tabela 8: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU Hidromorava

Nr	Zona e Furnizimit	Lloji i burimit	Përshkrimi i zonës administrative	Konsumi ditor (m ³ /ditë)	Shkalla e përputhshmërisë (%)	
					mikrobiol.	kimike
1	HM 01	Sipërfaqësor (Liqeni i Përlepticës)	Komuna e Gjilanit	12,000	100.0	99.77
2	HM 02	Nëntokësor (Puset e Velekincës)	Qyteti dhe fshatrat e Gjilanit	3,000	100.0	99.72
3	HM 03	Sipërfaqësor (Lumi Letnica)	Komuna e Vitisë	2,500	100.0	99.54
4	HM 04	Nëntokësor (puset e Kamenicës)	Komuna e Kamenicës	2,100	91.43	94.49
5	HM 05	Nëntokësor (puset Baja)	Komuna e Gjilanit	1,500	96.81	97.97
6	HM 06	Nëntokësor (pusi Dobërçan)	Komuna e Gjilanit	700	93.18	96.45
Zona e Shërbimit				21,800	97.5	98.2

Nga të dhënat e mësipërme mund të nxjerrren konkluzionet vijuese:

- (i) Cilësia më e mirë e përgjithshme e ujit është në komunën e Vitisë, ndërsa cilësia më e keqe është në komunën e Kamenicës;
- (ii) Cilësia e ujit në komunën e Gjilanit gjatë vitit 2016 ka ndryshuar nga zona në zonë: në zonën e furnizuar nga liqeni i Përlepticës dhe puset e Velekincës ka pasur pothuajse përputhshmëri të plotë, ndërsa në zonën e furnizuar nga puset e Bajës dhe sidomos, nga pusi i Dobërçanit shkalla e përpunshmërisë ka qenë relativisht e ulët;
- (iii) KRU Hidromorava duhet që të ndërmarr masa e duhura për adresimin e problemeve të cilat afektojnë cilësinë e ujit në zonat problematike (HM04, HM06 dhe HM05). Këto probleme janë të lidhura kryesisht me dezinfektimin/klorimin e ujit kështuqë Kompania duhet të hetojë dhe të gjej zgjidhje për shkaktarët konkret të klorimit të ujit në sistemet e ujësjellësit të Kamenicës si dhe sistemeve që furnizohen nga puset e Bajës dhe Dobërçanit në komunën e Gjilanit.

4.6 Cilësia e Ujit në ZFU-të e KRU Mitrovica

Në zonën e shërbimit të KRU Mitrovica janë përcaktuar 4 zona të furnizimit me ujë që korrespondojnë me 4 komunat e zonës së shërbimit (shih hartën në figurën e mëposhtme).




Figura 10: Harta me zonat e furnizimit me ujë të KRU MITROVICA

Të dhënat kryesore për ZFU të KRU Mitrovica si dhe cilësia kimike dhe mikrobiologjike në këto zona është paraqitur në tabelën 9 më poshtë.

Tabela 9: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU MITROVICA

Nr	Zona e Furnizimit	Lloji i burimit	Përshkrimi i zonës administrative	Konsumi ditor (m ³ /ditë)	Shkalla e përputhshmërisë (%)	
					mikrobiol.	kimike
1	MI 01	Sipërfaqësor (Liçeni i Ujmanit)	Komuna e Mitrovicës	36,000	99.89	100.0
2	MI 02	Sipërfaqësor (Liçeni i Ujmanit)	Komuna e Vushtrisë	11,000	98.11	99.86
3	MI 03	Sipërfaqësor (Liçeni i Ujmanit)	Komuna e Skenderajt	4,500	99.17	100.0
4	MI 04	Sipërfaqësor (Liçeni i Ujmanit)	M. Veriore dhe Zveçani	12,000	pa të dhëna	pa të dhëna
Zona e Shërbimit				63,500	98.9	99.9

Nga tabela e mësipërme mund të konkludohet me sa vijon:

- (i) Cilësia e ujit në komunën e Mitrovicës është në nivel jashtëzakonisht të lartë dhe praktikisht në përputhje të plotë me standardet e cilësisë;
- (ii) Cilësia e ujit në komunat e Vushtrisë dhe Skenderajt është gjithashtu në shkallë të lartë në përputhje me vlerat parametrike të cilësisë;
- (iii) Cilësia mikrobiologjike e ujit në komunën e Vushtrisë është praktikisht çështja e vetme problematike sa i takon menaxhimit të cilësisë së ujit të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU Mitrovica, hiç problematikën e komunave të Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit, për të cilat nuk ka të dhëna.

4.7 Cilësia e Ujit në ZFU-të e KRU Bifurkacioni

Në zonën e shërbimit të KRU Bifurkacioni janë përcaktuar 8 Zona të Furnizimi me Ujë shtrirja dhe kufijtë e të cilave janë paraqitur në hartën në Figurën 11 më poshtë.




Figura 11: Harta me zonat e furnizimit me ujë të KRU BIFURKACIONI

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të përmblhedhura të dhënat e monitorimit të cilësisë së ujit në ZFU sa i takon shkallës së përputhshmërisë me vlerat parametrike të cilësisë të përcaktuara me UA Nr. 16/2012.

Tabela 10: Zonat e furnizimit në zonën e shërbimit të KRU Bifurkacioni

Nr	Zona e Furnizimit	Lloji i burimit	Përshkrimi i zonës administrative	Konsumi ditor (m ³ /ditë)	Shkalla e përputhshmërisë (%)	
					mikrobiol.	kimike
1	BI 01	Sipërfaqësor (Lumi i Madh, Lumi i Vogël, Perroi i Sylës)	Komuna e Ferizajt	15,500	99.45	99.91
2	BI 02	Nëntokësor (burimi dhe puset)	10 fshatrat e komunës së Ferizajt	3,000	100.0	99.61
3	BI 03	Nëntokësor (burimi i Kaçanikut)	Komuna e Kaçanikut	3,500	98.57	100.0
4	BI 04	Kaçanik	Komuna e Kaçanikut		100.0	98.95
5	BI 05 ¹⁴	Nëntokësor (burim H. Elezit)	Komuna e Hanit të Elezit	1,900	85.29	88.76
6	BI 06 ¹⁵	Sipërfaqësor (Hani i Elezit)	Komuna e Hanit të Elezit	300	100.0	96.92
7	BI 07 ¹⁶	Nëntokësor (burimet Shtërpce)	Komuna e Shtërpces	300	100.0	96.88
8	BI 08 ¹⁷	Nëntokësore (Shtërpce)	Komuna e Shtërpces	300	100.0	95.9
Zona e Shërbimit				24,200	99.9	98.2

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën e mësipërme mund të nxjerren konkluzionet si vijon:

- (i) Në aspektin territorial cilësia e ujit në vitin 2016 ka qenë më e mira në komunën e Ferizajt me një shkallë të përputhshmërisë që është praktikisht plotësisht në pajtim me standardet e përcaktuara;
- (ii) Në aspektin mikrobiologjik cilësia e ujit të pijshëm në zonat e KRU Bifurkacioni është pothuajse në përputhje të plotë (99.9%) me vlerat parametrike të përcaktuara me standardet në fuqi. Zona e vetme problematike në kuptim të cilësisë mikrobiologjike të ujit është ajo në komunën e Kaçanikut-BI 05;

¹⁴ Nuk është ende nën autoritetin menaxhues të KRU Bifurkacioni;

¹⁵ Ibid;

¹⁶ Ibid;

¹⁷ Ibid.

-
- (iii) Në aspektin kimik shkalla e përputhshmërisë është më e ulët (98.2%) me problemet më të theksuara në Hanin e Elezit dhe komunën e Shtërpces.
 - (iv) Problemet e cilësisë së ujit në komunat e Hanit të Elezit dhe Shtërpçës duhet të adresohen gjatë vitit 2017 me rastin e rehabilitimit të këtyre sistemeve përmes PMUKR.

4.8 Përmbledhje e cilësisë së ujit në zonat e furnizimit të ujit

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në formë të përmbledhur një pasqyrë e cilësisë së ujit të pijshëm në Kosovë sipas parametrave për zonat e furnizimit të 7 KRU-ve. Në këtë tabelë, për qëllime të krahasimit janë paraqitur edhe të dhënat e cilësisë së ujit për vitin 2015, dhe rrjedhimisht mund të konfirmohet një tendencë e përmirësimit të cilësisë së ujit të furnizuar përmes sistemve publike të ujësjellësit gjatë periudhës 2015-2016.

Tabela 11: Përmbledhje e cilësisë së ujit në ZFU 2015-2016

Parametri	Përputhshmëria në 2015: 35 ZFU			Përputhshmëria në 2016: 44 ZFU		
	Nr. i testeve	%	ZFU me tejkalim	Nr. i testeve	%	ZFU me tejkalim
Koliformet totale	5,003	95.4	19	5,525	98.9	21
E coli	4,991	97.2	16	5,525	99.6	9
Klori rezidual	4,904	89	24	5,485	89.6	25
Turbullira	4,799	99.2	8	5,518	99.1	11
Era	1,760	100	0	2,026	100.0	0
Shija	1,760	100	0	2,026	100.0	0
pH	1,760	100	0	2,027	100.0	0
Nitratet	1,258	99.8	3	1,740	99.9	1
Nitritet	1,563	100.0	0	1,779	100.0	0
Hekuri	1,569	99.9	1	1,855	99.9	1
Mangan	1,306	99.0	10	1,726	99.9	1
Alumini	I përfshirë në "parametra të tjerë "me poshtë					2
Parametrat tjerë	12,692	99.3	19	14,023	99.7	15
Totali:	43,365	97.6		50,289	98.5	

5 Konkluzione: Sfidat e ardhshme

Cilësia e ujit të pijshëm që është furnizuar nga shtatë Kompanitë Rajonale të Ujësjes në vitin 2016 ka shënuar përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2015. Ky përmirësim, që është esencialisht e rëndësishme, është i konsiderueshëm sidomos sa i takon cilësisë mikrobiologjike të ujit që në vitin 2016 ka qenë në shkallën 99.2% (nga 96.3% sa ishte në vitin 2015) nivel ky që edhe sipas standardeve të BE-së konsiderohet si përputhsmëri e plotë.

Përkundër këtij përmirësimi, me qëllim të krijimit të një sistemi më efikas të procesit të monitorimit dhe të menaxhimit të cilësisë së ujit të pijshëm, fokusi i angazhimeve të Qendrës së Ujit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e institucioneve relevante në periudhën e ardhshme duhet të përqëndrohet në adresimin e sfidave si vijon:

1. **Konsolidimi i mëtutjeshëm institucional i Qendrës së Ujit** me personelin e nevojshëm në pajtim me strukturën e paraparë organizative.

Viteve të fundit ka pasur zhvillime jashtëzakonisht pozitive sa i takon kontrollimit të cilësisë së ujit përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve të Qendrës së Ujit. Këto zhvillime pozitive janë arritur me mbështetjen e donatorëve dhe organeve përgjegjëse të Ministrisë dhe Qeverisë. Megjithatë, për ekzekutimin efektiv të përgjegjësive ligjore që ka Qendra e Ujit për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm duhet që të investohet edhe më tutje në ngritjen e kapaciteteve të saj, para së gjithash në rritjen dhe aftësimin e mëtutjeshëm të personelit përmes trajnimeve të ndryshme.

2. **Ngritja e kapaciteteve të KRU-ve për monitorimin e cilësisë së ujit** që e furnizojnë.

Përbushja e obligimeve që kanë KRU-të sipas UA Nr. 16/2012 sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm imponon nevojën për ndërmarrjen dhe kompletimin e disa proceseve të cilat tashmë kanë filluar, siç janë:

- (i) akreditimi i laboratorëve (KRU Prishtina dhe KRU Radoniqi tashmë i kanë akredituar laboratorët e tyre),
- (ii) zhvillimi dhe mirëmbajtja e një databaze për përpunimin e rezultateve të monitorimit të brendshëm,
- (iii) kompletimi i personelit të departamenteve të cilësisë së ujit,
- (iv) krijimi dhe zbatimi i procedurave operative standarde për menaxhimin e cilësisë së ujit të pijshëm, etj.

-
3. **Zbatimi efektiv nga institucionet përgjegjëse** (IKSHPK, KRU-të, komunat, ARRU) i procedurave për menaxhimin e rasteve të mospërputhjes me vlerat parametrike të cilësisë së ujit të pijshëm dhe rregulloreve tjera të miratuara bazuar në UA nr. 16/2012.

Për qëllime të zbatimit të këtyre procedurave rregulloreve, konsiderohet që do të duhej që të përpilohen një numër udhëzimesh teknike për të ndihmuar të Qendrën e Ujit/IKSHPK-në dhe KRU-të në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave kryesore të UA 16/2012. Në mënyrë specifike, hartimi i disa udhëzimeve të detajuara që do të ndihmonin KRU-të në zbatimin e përgjegjësive të tyre për "monitorim të brendshëm" në pajtim me praktikat e mira ndërkombëtare është me interes të veçantë.

4. **Krijimi dhe zbatimi i një sistemi të aprovimit të produkteve dhe materialeve në kontakt me ujin e pijshëm.**

Për materialet dhe produktet që vijnë në kontakt me ujin përfshirë edhe substancat dhe pajisjet që shfrytëzohen për përmirësimin e cilësisë së ujit, duhet të hartohet një skemë sipas të cilës këto materiale dhe produkte i nënshtrohen kontrollimit dhe aprovimit nga një institucion përgjegjës vendor (p.sh. IKSHPK) para se të përdoren. Ky kontroll dhe aprovim është i domosdoshëm për të siguruar që të njëjtat materiale dhe produkte nuk do të kenë ndikim negativ në cilësinë e ujit me të cilin do të jenë në kontakt.

5. **Zgjidhja e qëndrueshme afatgjate e monitorimit të parametrave radioaktiv të cilësisë së ujit të pijshëm.**

Parametrat radioaktiv (tritiumi dhe ID-doza indikative) aktualisht janë duke u monitoruar nga AKMRrSB e cila në mungesë të kapaciteteve, si solucion afatshkurtër po ndihmohet për këtë qëllim nga laboratorit IRE ELIT-Begjikë. Megjithatë, për zgjidhjen afatgjate dhe të qëndrueshme të monitorimit të këtyre parametrave në pajtim me UA nr. 16/2012 si dhe Direktivën 2013/51/Euratom është e domosdoshme që të krijohen kapacitete profesionale dhe pajisje adekuate për këtë qëllim qoftë (a) në kuadër të IKSHPK, apo (b) në kuadër të një instituti brenda Universitetit të Prishtinës.

6. **Kontrollimi i cilësisë së ujit për sistemet e vogla të ujësjellësit të cilat aktualisht nuk menaxhohen nga KRU-të.**

Procesi i integritimit të të gjitha sistemeve komunale dhe rurale të ujësjellësit në KRU, që është politikë e Qeverisë së Kosovës, ende nuk është kompletuar plotësisht. Kështu, në rajonin e Gjilanit (zona e shërbimit të KRU Hidromorava) janë nënshkruar marrëveshjet për shërbim (në vitin 2015) ndërmjet KRU Hidromorava dhe të gjitha (katër) komunave të tjera d.m.th., i Ranillugut, Klllokotit, Parteshit dhe Novobërdës, megjithatë integrimi faktik i këtyre komunave është duke vazhduar dhe planifikohet të përfundojë plotësisht në vitin 2017 pas rehabilitimit të sistemeve të ujësjellësve përmes projektit që është duke u realizuar e që financohet nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria Zvicerane. Edhe në rajonin e Ferizajt (zona e shërbimit të KRU Bifurkacioni) janë nënshkruar marrëveshjet e shërbimit në mes të KRU Bifurkacioni me dy komunat e këtij rajoni që ende nuk janë integruar d.m.th me

komunën Hani i Elezit dhe komunën Shtërpçë, ndërkaq integrimi faktik pritet të ndodh gjatë vitit 2017 (i njëjti plan sikur me komunat në rajonin e Gjilanit). Në këtë mënyrë, procesi i konsolidimit në Kosovën jug-lindore pritet të përfundojë dhe të bëhet plotësisht funksional në fund të 2017.

Në komunat e Kosovës Veriore (Zveçan, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok dhe Leposaviq) fatkeqësisht nuk ka pasur zhvillime/progres të dukshëm në integrim.

Monitorimi dhe menaxhimi i cilësisë së ujit në këto komuna si dhe në sistemet e vogla rurale të ujësjellësit të cilat gjithashtu pritet të integrohen brenda KRU-ve me sistemin dhe dinamikën e njëjtë sikurse komunat e përmendura më sipër, është një sfidë për KRU-të dhe IKSHPK e cila kërkon mobilizim shtesë dhe kapacitete adekuate të tyre për adresimin me sukses të kësaj sfide.

SHTOJCA 1: FJALORI I TERMAVE

Substanca	Përshkrimi	Standardi
<i>Parametrat mikrobiologjikë</i>		Sasia e lejuar
Koliformet fekale, streptokoku fekal, <i>Clostridium perfringens</i>	Koliformet fekale, streptokoket fekale dhe <i>Clostridium perfringens</i> janë të pranishme në zorrën e të gjitha kafshëve gjaknxehta. Prania e tyre në ujin e furnizuar tregon nevojën për të ndërmarrë veprim të menjëhershëm për të eliminuar burimet e ndotjes fekale. Mostrat dhe testet individuale bëhen për secilin organizëm. Këta organizma kontrollohen përmes dezinfektimit të ujit.	0 për 100 ml
Koliformet totale	Grupi koliform i organizmave është i shpërndarë gjerësisht në ambient, për shembull përmes aktivitetit të njerëzve dhe të kafshëve dhe përmes materialeve të perimeve. Prania e tyre në furnizimet me ujë tregon nevojën për hetim të burimit të kontaminimit. Numra koliform kontrollohen përmes dezinfektimit të ujit.	0 për 100 ml
Alkaline	Përqendrimi i këtij parametri është indikacion i fortësisë natyrore dhe pH-së së ujit.	Nuk ka standard
Alumini	Ndodh natyrshëm në disa burime të ujit. Ky alumin largohet gjatë proceseve të trajtimit të ujit (koagulimit dhe filtrimit). Sulfati i aluminit mund të përdoret për si kimikat për trajtimin e ujit për të hequr turbullirën.	200 µg/l
Amoniumi	Kripërat e amonit zakonisht janë të pranishme në sasi të vogla në shumicën e burimeve të ujit. Ato dekompozohen gjatë dezinfektimit.	0.5 mg/l
Antimoni	Antimoni është toksik dhe nuk është i pranishëm në burime të ujit. Përqendrime të vogla në ujin e pijshëm, që nuk kanë kurrfarë domethënie për shëndetin, mund të rrjedh nga pajisjet e tunxhit dhe nga materialet e saldimit.	10 µg/l
Arseni	I pranishëm në mënyrë të natyrshme në nivele të vogla në shumë pak burime të ujërave nëntokësore. Arseni është toksik dhe kur është i pranishëm ai eliminohet me proceset e specializuara të trajtimit të ujit.	50 µg/l
Bariumi	Gjendet natyrshëm në përqendrime të vogla në disa burime të ujit. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin asnjë rrezik për shëndetin.	1000 µg/l
Bori	Bori në burimet e ujit vjen nga mbetjet e formulimeve të detergjentit që janë të pranishme në rrjedhjet ujërave të zeza të trajtuara. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin asnjë rrezik për shëndetin.	2000 µg/l
Kadmiumi	Kadmiumi është toksik dhe i pranishëm në nivele të vogla në pak burime të ujit nëntokësor. Kur është i pranishëm ai hiqet përmes proceseve të specializuara të trajtimit të ujit.	5 µg/l
Kalciumi	Gjendet natyrshëm në të gjitha burimet e ujit dhe bashkë me magnezin është përgjegjës për fortësinë e ujit, e cila shkakton	250 mg/l

	gurëzit në çajnik dhe në sistemet e ujit të nxehtë. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin asnjë rrezik për shëndetin.	
Kloruri	Në lidhje me natriumin, kloruri gjendet natyrshëm si kripë shumë e dobësuar në të gjitha burimet e ujit dhe nuk hiqet gjatë trajtimit të ujit. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin asnjë rrezik për shëndetin.	400 mg/l
Klori	Gazi i klorit përdoret si dezinfektues në trajtimin e ujit. Ai shkatërron bakteret e krijuara nga mbeturinat e kafshëve dhe rrjedhjet e ujërave të zeza.	Nuk ka standard
Kromi	Nuk është i pranishëm në burimet e ujit dhe nuk gjendet në ujin e pijshëm.	50 µg/l
Ngjyra	Ngjyra gjendet natyrshëm në ujë nga burimet në kodrinat larta. Ngjyra hiqet gjatë proceseve të trajtimit të ujit (koagulimit dhe filtrimit)	20 mg/l Pt/Co shkallë
Përçueshmëria	Përçueshmëria elektrike është matje e sasisë së substancave inorganike të tretura në ujin e burimit. Ai përdoret për të ndihmuar kontrollin e trajtimit.	1500 µS/cm
Bakri	Nivelet e ulëta të bakrit, që janë jo domethënëse për shëndetin, gjenden natyrshëm në shumë burime të ujit dhe përqendrime të konsiderueshme mund të gjenden në rubinete e konsumatorëve si pasojë e gypave të bakrit. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin asnjë rrezik për shëndetin.	3000 µg/l
Cianid	Cianidi është toksik dhe nuk është i pranishëm në burimet e ujit. Ai nuk gjendet në ujin e pijshëm.	50 µg/l

Substanca	Përshkrimi	Standardi
<i>Parametrat kimikë</i>		Sasia e lejuar
Fluoruri	Nivelet e ulëta të fluorurit gjenden natyrshëm në shumë burime të ujit, veçanërisht në ujërat tokësore. Ai nuk hiqet me trajtimin konvencional të ujit dhe disa kompani të ujësjellësve e fluoridoj furnizimet e ujit si mbrojtje kundër prishjes së dhëmbëve.	1500 µg/l
Hidrokarburi	Hidrokarburet përfshijnë naftën, vajrat minerale dhe produktet e tjera të industrisë petro-kimike. Kontaminimi i herë pas herëshëm i lokalizuara i ujërave tokësore mund të gjendet ose të depërtojnë prej gypave të plastikës të ujit përmes kushteve të tokës së kontaminuar. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin ndonjë rrezik për shëndetin por mund rrisin shijen/aromën.	10 µg/l
Joni i hidrogjenit	Shih pH	
Hekuri	I pranishëm natyrshëm në shumë burime të ujit. Ky hekur eliminohet gjatë trajtimit të ujit. Hekuri në furnizimet me ujë po ashtu mund të buron nga ndryshkja e hekurit në gypit kryesor, por jo çdo përqendrim i pranishëm në ujë paraqet rrezik për shëndetin. Përbërësit e hekurit përdoren për trajtimin e ujit për të eliminuar turbullirën.	200 µg/l
Plumbi	Nuk është zakonisht i pranishëm në burimet e ujit por mund të jetë i pranishëm në rubinetet e konsumatorëve nëse	50 µg/l

	gypat janë të plumbit. Nëse ui i pijshëm ka tendencë të tret plumbin, kompanitë e ujit duhet të mbrojnë shëndetin e konsumatorëve dhe të trajtojnë ujin për të ulur ekspozimin.	
Magnezi	Është i pranishëm në të gjitha burimet e ujit dhe bashkë me kalciumin është përgjegjës për fortësinë e ujit, i cili shkakton gurëzit në çajnikë dhe në sisteme të ujit të nxehtë. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin asnjë rrezik për shëndetin.	50 mg/l
Mangani	I pranishëm natyrshëm në shumë burime të ujit dhe hiqet gjatë trajtimit të ujit.	50 µg/l
Zhiva	Zhiva është toksik dhe nuk është e pranishme në burimet e ujit ose në ujin e pijshëm.	1 µg/l
Nikeli	Nuk gjendet në burimet e ujit. Sasitë e vogla të gjetura në ujin e pijshëm mund të burojnë nga mbështjellësi mbrojtës në rubinete ose pajisje. Këto sasi të vogla nuk paraqesin rrezik për shëndetin.	50 µg/l
Nitrati	I pranishëm natyrshëm në të gjitha burimet e ujit, edhe pse përqendrimet e mëdha mund të shkaktohen nga përdorimi i plehrave. Kur është e nevojshme, nivelet e nitratis zvogëlohen gjatë trajtimit të ujit (shkëmbimin e joneve ose përzierja me ujin me pak nitrat).	50 mg/l
Nitriti	Sasitë e vogla të nitritit prodhohen kur klori dhe amoniumet përdoren në procesin e dezinfektimit. Nivelet minimizohen përmes operimit të kujdesshëm të procesit dezinfektues.	0.1 mg/l
Oksidueshmëria	Oksidueshmëria e ujit paraqet masën e përmbajtjes së tij organike. Kjo është masë alternative e TOC.	5 mg/l
PAH	Hidrokarburet aromatike policiklike janë të pranishme në shtresat e brendshme të katranit të përdorura për mbrojtjen e gypave kryesor të ujit para vitit 1970. Sasitë e vogla të PAH-së në përqendrimet që nuk janë domethënëse për shëndetin, janë të pranishme në ujin e rubineteve nëse ende ka prani të shtresës origjinale të katranit.	0.2 µg/l
Benzo 3,4 pireni (PAH)		10 ng/l
Pesticidet	Shumë burime të ujit përmbajnë sasi të vogla të mbetjeve të pesticideve toksike si rezultat i përdorimit bujqësor dhe jobujqësor të pesticideve në të lashta dhe për kontrollimin e barojave. Kur është e nevojshme, kompanitë e ujit kanë instaluar procese të veçanta të trajtimit për të mbrojtur shëndetin publik duke eliminuar pesticidet (duke aktivizuar proceset e karbonit dhe ozonit).	0.1 µg/l
pH (jonet e hidrogjenit)	Vlera pH ose përqendrimi i jonit të hidrogjenit jep indikacion të shkallës së aciditetit të ujit. Vlera pH7 është neutrale; vlerat nën 7 tregojnë karakteristika acidike dhe vlerat më të larta se 7 tregojnë karakteristikat bazike. Vlera e ulët e pH mund të rezultojë në ndryshkjen e gypit. Një alkali i cili nuk është i dëmshëm për shëndetin mund të shtohet para furnizimit që të minimizohet ndryshkja (korrozioni).	5.5-9.5
Fosfori	Sasitë e vogla të kripës së fosforit gjenden natyrshëm në	2200 µg/l


	shumë burime të ujit dhe përqendrimet e larta lidhen me rrjedhjen e ujërave të zeza të trajtuara dhe plehtrat bujqësor. Fosfatet përdoren edhe në trajtimin e ujit si masë për mbrojtjen e shëndetit për uljen e përmbajtjes së plumbit që mund të vij nga gypat e konsumatorëve. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin rrezik për shëndetin.	
Kaliumi	Gjendet natyrshëm në të gjitha burimet e ujit dhe largohet gjatë trajtimit të ujit. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin rrezik për shëndetin.	12 mg/l
Aroma dhe shija cilësore	Aroma dhe shija gjenden natyrshëm, veçanërisht në burimet sipërfaqësore gjatë verës. Testimet në terren tregojnë çdo aromë dhe shije potenciale. Materiet organike që shkaktojnë aromën dhe shijet hiqen gjatë procesit të trajtimit të ujit (karbon ose ozon i aktivizuar).	Nuk ka standard
Aroma dhe shija sasiore	Një metodë formale ndërmerret në laborator për të matur aromën dhe shijen në ujë. Zhvillohen testet individuale dhe çdo e metë mënjanohet gjatë procesit të trajtimit siç përshkruhet më lartë.	Hollimi no nga 3 në 25 °C
Seleni	Seleni është toksik dhe nuk është i pranishëm në burimet e ujit dhe nuk gjendet në ujin e pijshëm.	10 µg/l
Argjendi	Nuk është i pranishëm në burimet e ujit dhe zakonisht nuk gjendet në ujin e pijshëm publik. Argjendi mund të përdoret si dezinfektues për furnizimet e vogla private.	10 µg/l
Natriumi	Në lidhje me kloridin, natriumi gjendet natyrshëm si kripë shumë e holluar në të gjitha burimet e ujit dhe nuk hiqet gjatë trajtimit të ujit. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin rrezik për shëndetin.	150 mg/l
Sulfati	Gjendet natyrshëm në të gjitha ujërat e burimeve dhe nuk hiqet gjatë trajtimit të ujit. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin rrezik për shëndetin.	250 mg/l
Agjentët tensioaktiv	Agjentët tensioaktiv në burimet e ujit vijnë nga mbetjet e formulimeve të detergjentit që janë të pranishme në rrjedhjet e ujërave të zeza të trajtuara. Ato hiqen gjatë trajtimit.	200 µg/l
Temperatura	Temperatura e ujërave sipërfaqësore ndryshon sipas stinës. Ujërat nëntokësore kanë ndryshime shumë më të vogla të temperaturës.	25°C
Tetrakloroetin		10 µg/l
Tetraklorometan	Këta tretës mund të jenë të pranishëm në përqendrime të vogla në ujërat nëntokësore nën zonat industriale. Kur është e nevojshme, përdoret trajtimi i specializuar për mbrojtjen e shëndetit publik duke hequr tretësit nga uji i pijshëm.	3 µg/l
Trikloroeten		30 µg/l
Trihalometanet (THM)	THM-të formohen gjatë procesit të dezinfektimit me reaksionin ndërmjet klorit dhe substancave organike që gjenden në formë natyrore. Proceset e trajtimit kontrollohen për të minimizuar prodhimin e tyre.	100 µg/l
Turbullira	Të gjitha ujërat e burimeve janë natyrshëm të errët kohë pas kohe. Turbullira është masë sasiore e turbullirës dhe	4 formazin njësi të

	nivelet kontrollohen me procesin e trajtimit.	turbullirës
Solidet totale të thara	Kjo është masë e mineraleve që gjenden natyrshëm në ujë.	1500 mg/l
Fortësia totale	Kjo përfaqëson përqendrimin e kalciumit që gjendet natyrshëm dhe magnezit në ujin e burimit. Uji i fortë mund të shkaktoj formimin e gurëzive në çajnikë dhe në sistemet e ujit të nxehtë. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin rrezik për shëndetin.	Nuk ka standard
Karboni totalisht organik (TOC)	TOC paraqet sasinë totale të materies organike të pranishme në ujë. Përqendrimet e pranishme në ujë nuk paraqesin rrezik për shëndetin.	Pa rritje të dukshme
Zinku	Përqendrimi i konsiderueshëm i zinkut në ujë gjendet vetëm në objektet që shërbehen përmes gypave të hekurit të galvanizuar. Sasitë e vogla të zinkut që nuk janë domethënëse për shëndetin mund të krijohen nga materialet e saldimit	5000 µg/l

SHTOJCA 2: ZONAT E SHËRBIMIT TË KRU-VE


2.1 KRU Prishtina

Zona e shërbimit e KRU Prishtina përfshin komunitat: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Shtime, Gllgovc, Graçanicë (shih hartën në figurën e mëposhtme).




2.2 KRU Hidroregjioni Jugor

Zona e shërbimit e KRU Hidroregjioni Jugor është paraqitur në hartën më poshtë dhe ajo përfshin komunat: Prizren, Suharekë, Malishevë, Dragash dhe Mamushë.




2.3 KRU Hidrodrini

Zona e shërbimit e KRU Hidrodrini është paraqitur në hartën më poshtë dhe ajo përfshin komunat: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.



2.4 KRU Radoniqi


Zona e shërbimit e KRU Radoniqi përfshin komunat: Gjakovë, Rahovec dhe disa fshatra të komunës së Prizrenit (shih hartën në figurën e mëposhtme).



2.5 KRU Hidromorava


Zona e shërbimit e KRU Hidromorava përfshin komunat: Gjilan, Viti, Kamenicë (shih hartën në figurën 10 më poshtë).

Komunat Partesh, Ranillug, Kllokot dhe Novobërdë kanë nënshkruar Marrëveshje Shërbimi me KRU Hidromorava për t'u integruar brenda kësaj Kompanie dhe ky integrim pritet të ndodhë gjatë vitit 2017 pasi të jenë rehabilituar sistemet e furnizimit me ujë të këtyre komunave përmes projektit të bashkëfinancuar nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria Zvicerane - Programi për Mbështetjen e Ujësjetësve dhe Kanalizimeve Rurale (PMUKR).



2.6 KRU Mitrovica


Zona e shërbimit e KRU Mitrovica përfshin komunitat: Mitrovicë, Vushtri dhe Skenderaj (shih hartën më poshtë).



2.7 KRU Bifurkacioni

Zona e shërbimit e KRU Bifurkacioni përfshin komunat: Ferizaj dhe Kaçanik (shih hartën në figurën 8 më poshtë).

Komunat e Shtërpcës dhe Hanit të Elezit kanë nënshkruar marrëveshje shërbimi me KRU Bifurkacioni dhe integrimi faktik i këtyre komunave pritet të ndodhë gjatë vitit 2017 pasi të jenë rehabilituar këto sisteme përmes PMUKR.



SHTOJCA 3: PËRMBLEDHJE E RAPORTEVE VJETORE PËR CILËSINË E UJIT PËR SECILËN KRU

KRU „PRISHTINA“

TABELA 3.1: FORMA STANDARDE E RAPORTIT VJETOR PER CILESINE E UJIT PER PIJE

Ref. No	Parametri	Parametric value (limit)	Njësia	Nr. i testeve	Nr. i testeve me përputhje	Nr. i testeve pa përputhje	Përqindja e përputhjes	Përqindja e mospërputhjes
1	Era	Odour, Taste	numer /100 ml	462	462	0	100.00%	0.00%
2	Ngjyra	Colour	°Co-Pt	462	462	0	100.00%	0.00%
3	Shija	Odour, Taste	numer /100 ml	462	462	0	100.00%	0.00%
4	Klori residual	Residual Desinfectant	mg/l	1508	1247	261	82.69%	17.31%
5	Kloruret	Chloride	mg/l	279	279	0	100.00%	0.00%
6	Turbullira	Turbidity (not NTU)	NTU	1508	1508	0	100.00%	0.00%
7	pH	pH	x	464	464	0	100.00%	0.00%
8	Përcueshmëria	Conductivity	µS/cm	464	464	0	100.00%	0.00%
9	Hekuri (Fe)	Iron(Fe)	mg/l	461	461	0	100.00%	0.00%
10	Alumini – Al	Alumuminium	mg/l	369	366	3	99.19%	0.81%
11	Amoniaku	Amonium	mg/l	461	461	0	100.00%	0.00%
12	Nitrite	Nitrite	mg/l	215	215	0	100.00%	0.00%
13	Nitratet	Nitrate	mg/l	215	213	2	99.07%	0.93%
14	Harxhimi i oksigjenit	Oxidability	mg/l Oâ,,	443	442	1	99.77%	0.23%
15	Escherichia coli (E. coli)	E. Coli (0, <300, >300)	numer /100 ml	1515	1515	0	100.00%	0.00%
16	Bakteret koliforme	Total coliform 0 tolerance	numer /100 ml	1515	1512	3	99.80%	0.20%
18	Numri i kolonive në 37 °C	Colony Count 37 C	numer /100 ml	464	462	2	99.57%	0.43%
19	Fluoruret	Fluoride	mg/l	19	19	0	100.00%	0.00%
20	Cianuret	Cyanide	µg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
21	Karboni Total Organik / TOC	TOC	mg/l	13	13	0	100.00%	0.00%
22	Bakri – Cu	Cu	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
23	Kadmium	Cd	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
24	Plumb	Pb	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
25	Nikli (Ni)	Ni	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
26	Kromi (Cr)	Cr	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
27	Arseni (As)	As	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
28	Selen (Se)	Se	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
29	Antimoni (Sb)	Sb (Antimony)	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
30	Merkur (Hg) – Zhiva	Hg (Mercury)	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
31	Mangani – Mn	Manganese(Mn)	mg/l	237	237	0	100.00%	0.00%
32	Zinku	Zn	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
33	THM	THM (Trihalometanet - total)	µg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
34	Index Harxhimi i KMNO4	Index Harxhimi i KMNO4	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%

KRU "HIDROREGJIONI JUGOR"

TABELA 3.2: FORMA STANDARDE E RAPORTIT VJETOR PER CILESINE E UJIT PER PIJE

Ref. No	Parametri	Parametric value (limit)	Njësia	Nr. i testeve	Nr. i testeve me përputhje	Nr. i testeve pa përputhje	Përqindja e përputhjes	Përqindja e mospërputhjes
1	Era	Odour, Taste	numer /100 ml	315	315	0	100.00%	0.00%
2	Ngjyra	Colour	°Co-Pt	315	315	0	100.00%	0.00%
3	Shija	Odour, Taste	numer /100 ml	315	315	0	100.00%	0.00%
4	Klori residual	Residual Desinfectant	mg/l	746	744	2	99.73%	0.27%
5	Kloruret	Chloride	mg/l	315	315	0	100.00%	0.00%
6	Turbullira	Turbidity (not NTU)	NTU	748	748	0	100.00%	0.00%
7	pH	pH	x	315	315	0	100.00%	0.00%
8	Përçueshmëria	Conductivity	µS/cm	315	315	0	100.00%	0.00%
9	Hekuri (Fe)	Iron(Fe)	mg/l	315	313	2	99.37%	0.63%
10	Alumini – Al	Aluminium	mg/l	229	229	0	100.00%	0.00%
11	Amoniaku	Amonium	mg/l	315	315	0	100.00%	0.00%
12	Nitrite	Nitrite	mg/l	315	315	0	100.00%	0.00%
13	Nitratet	Nitrate	mg/l	315	315	0	100.00%	0.00%
14	Harxhimi i oksigjenit	Oxidability	mg/l Oâ,,	108	108	0	100.00%	0.00%
15	Escherichia coli (E. coli)	E. Coli (0, <300, >300)	numer /100 ml	748	734	14	98.13%	1.87%
16	Bakteret koliforme	Total coliform 0 tolerance	numer /100 ml	748	737	11	98.53%	1.47%
18	Numri i kolonive në 37 °C	Colony Count 37 C	numer /100 ml	306	300	6	98.04%	1.96%
21	Karboni Total Organik / TOC	TOC	mg/l	5	5	0	100.00%	0.00%
22	Bakri – Cu	Cu	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
23	Kadmium	Cd	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
24	Plumb	Pb	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
25	Nikli (Ni)	Ni	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
26	Kromi (Cr)	Cr	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
27	Arseni (As)	As	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
28	Selen (Se)	Se	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
29	Antimoni (Sb)	Sb (Antimony)	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
30	Merkur (Hg) – Zhiva	Hg (Mercury)	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
31	Mangani – Mn	Manganese (Mn)	mg/l	324	322	2	99.38%	0.62%
32	Zinku	Zn	mg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
33	THM	THM (Trihalometanet - total)	µg/l	7	7	0	100.00%	0.00%
34	Index Harxhimi i KMNO4	Index Harxhimi i KMNO4	mg/l	206	206	0	100.00%	0.00%

KRU "HIDRODRINI"

TABELA 3.3: FORMA STANDARDE E RAPORTIT VJETOR PER CILESINE E UJIT PER PIJE

Ref. No	Parametri	Parametric value (limit)	Njësia	Nr. i testeve	Nr. i testeve me përputhje	Nr. i testeve pa përputhje	Përqindja e përputhjes	Përqindja e mospërputhjes
1	Era	Odour, Taste	numer /100 ml	462	462	0	100.00%	0.00%
2	Ngjyra	Colour	°Co-Pt	462	462	0	100.00%	0.00%
3	Shija	Odour, Taste	numer /100 ml	462	462	0	100.00%	0.00%
4	Klori residual	Residual Desinfectant	mg/l	1508	1247	261	82.69%	17.31%
5	Kloruret	Chloride	mg/l	279	279	0	100.00%	0.00%
6	Turbullira	Turbidity (not NTU)	NTU	1508	1508	0	100.00%	0.00%
7	pH	pH	x	464	464	0	100.00%	0.00%
8	Përçueshmëria	Conductivity	µS/cm	464	464	0	100.00%	0.00%
9	Hekuri (Fe)	Iron(Fe)	mg/l	461	461	0	100.00%	0.00%
10	Alumini - Al	Aluminium	mg/l	369	366	3	99.19%	0.81%
11	Amoniaku	Amonium	mg/l	461	461	0	100.00%	0.00%
12	Nitrite	Nitrite	mg/l	215	215	0	100.00%	0.00%
13	Nitratet	Nitrate	mg/l	215	213	2	99.07%	0.93%
14	Harxhimi i oksigjenit	Oxidability	mg/l Oâ,,	443	442	1	99.77%	0.23%
15	Escherichia coli (E. coli)	E. Coli (0, <300, >300)	numer /100 ml	1515	1515	0	100.00%	0.00%
16	Bakteret koliforme	Total coliform 0 tolerance	numer /100 ml	1515	1512	3	99.80%	0.20%
18	Numri i kolonive në 37 °C	Colony Count 37 C	numer /100 ml	464	462	2	99.57%	0.43%
19	Fluoruret	Fluoride	mg/l	19	19	0	100.00%	0.00%
20	Cianuret	Cyanide	µg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
21	Karboni Total Organik / TOC	TOC	mg/l	13	13	0	100.00%	0.00%
22	Bakri - Cu	Cu	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
23	Kadmium	Cd	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
24	Plumb	Pb	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
25	Nikli (Ni)	Ni	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
26	Kromi (Cr)	Cr	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
27	Arseni (As)	As	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
28	Selen (Se)	Se	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
29	Antimoni (Sb)	Sb (Antimony)	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
30	Merkur (Hg) - Zhiva	Hg (Mercury)	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
31	Mangani - Mn	Manganese(Mn)	mg/l	237	237	0	100.00%	0.00%
32	Zinku	Zn	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%
33	THM	THM (Trihalometanet - total)	µg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
34	Index Harxhimi i KMNO4	Index Harxhimi i KMNO4	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%

KRU "RADONIQI"

TABELA 3.4: FORMA STANDARDE E RAPORTIT VJETOR PER CILESINE E UJIT TË PIJSHËM

Ref. No	Parametri	Parametric value (limit)	Njësia	Nr. i testeve	Nr. i testeve me përputhje	Nr. i testeve pa përputhje	Përqindja e përputhjes	Përqindja e mospërputhjes
1	Era	Odour, Taste	numer /100 ml	299	299	0	100.00%	0.00%
2	Ngjyra	Colour	°Co-Pt	299	299	0	100.00%	0.00%
3	Shija	Odour, Taste	numer /100 ml	299	299	0	100.00%	0.00%
4	Klori rezidual	Residual Desinfectant	mg/l	576	576	0	100.00%	0.00%
5	Kloruret	Chloride	mg/l	299	299	0	100.00%	0.00%
6	Turbullira	Turbidity (not NTU)	NTU	576	576	0	100.00%	0.00%
7	pH	pH	x	299	299	0	100.00%	0.00%
8	Përçueshmëria	Conductivity	µS/cm	299	299	0	100.00%	0.00%
9	Hekuri (Fe)	Iron(Fe)	mg/l	299	299	0	100.00%	0.00%
10	Alumini - Al	Aluminium	mg/l	299	299	0	100.00%	0.00%
11	Amoniaku	Amonium	mg/l	299	299	0	100.00%	0.00%
12	Nitrite	Nitrite	mg/l	299	299	0	100.00%	0.00%
13	Nitratet	Nitrate	mg/l	299	299	0	100.00%	0.00%
14	Harxhimi i oksigjenit	Oxidability	mg/l Oâ,,	22	22	0	100.00%	0.00%
15	Escherichia coli (E. coli)	E. Coli (0, <300, >300)	numer /100 ml	576	576	0	100.00%	0.00%
16	Bakteret koliforme	Total coliform 0 tolerance	numer /100 ml	576	576	0	100.00%	0.00%
17	Numri i kolonive në 22 °C	Colony count 22 C	numer /100 ml	298	298	0	100.00%	0.00%
18	Numri i kolonive në 37 °C	Colony Count 37 C	numer /100 ml	298	298	0	100.00%	0.00%
21	Karboni Total Organik / TOC	TOC	mg/l	14	14	0	100.00%	0.00%
22	Bakri - Cu	Cu	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
23	Kadmium	Cd	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
24	Plumb	Pb	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
25	Nikli (Ni)	Ni	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
26	Kromi (Cr)	Cr	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
27	Arseni (As)	As	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
28	Selen (Se)	Se	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
29	Antimoni (Sb)	Sb (Antimony)	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
30	Merkur (Hg) - Zhiva	Hg (Mercury)	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
31	Mangani - Mn	Manganese(Mn)	mg/l	321	321	0	100.00%	0.00%
32	Zinku	Zn	mg/l	22	22	0	100.00%	0.00%
34	Index Harxhimi i KMNO4	Index Harxhimi i KMNO4	mg/l	272	272	0	100.00%	0.00%
33	THM	THM (Trihalometanet - total)	µg/l	9	9	0	100.00%	0.00%
34	Index Harxhimi i KMNO4	Index Harxhimi i KMNO4	mg/l	26	26	0	100.00%	0.00%

KRU "HIDROMORAVA"

TABELA 3.5: FORMA STANDARDE E RAPORTIT VJETOR PER CILESINE E UJIT PER PIJE

Ref. No	Parametri	Parametric value (limit)	Njësia	Nr. i testeve	Nr. i testeve me përputhje	Nr. i testeve pa përputhje	Përqindja e përputhjes	Përqindja e mospërputhjes
1	Era	Odour, Taste	numer /100 ml	171	171	0	100.00%	0.00%
2	Ngjyra	Colour	°Co-Pt	171	171	0	100.00%	0.00%
3	Shija	Odour, Taste	numer /100 ml	171	171	0	100.00%	0.00%
4	Klori rezidual	Residual Desinfectant	mg/l	453	416	37	91.83%	8.17%
5	Kloruret	Chloride	mg/l	171	171	0	100.00%	0.00%
6	Turbullira	Turbidity (not NTU)	NTU	453	446	7	98.45%	1.55%
7	pH	pH	x	171	171	0	100.00%	0.00%
8	Përçueshmëria	Conductivity	µS/cm	171	171	0	100.00%	0.00%
9	Hekuri (Fe)	Iron(Fe)	mg/l	171	171	0	100.00%	0.00%
10	Alumini - Al	Alumuminium	mg/l	80	80	0	100.00%	0.00%
